



Koha

www.koha.mk



KOHA për
InfraRed

EDITORIAL

**Paqja politike
që pi ujë në
burimet e
kriminelëve!**



Pambrëmë u arrestua ish-krye-
parlamentari Trajko Velanovski.
Ai dyshohet se bashkë me disa të
tjerë nga partia e tij, kanë organi-
zuar ngjarjet e përgjakshme në
Parlament, më 27 prilli 2017. Por
dyshimet nuk përfundojnë me
kaq. Po del se kryeorganizatori i
kësaj skeme...

GLOBI

**Nëse Kosova e
Serbia arrijnë
marrëveshje,
mos t'ua zëmë
rrugën**

RAJON

**Pse nuk
po përfiton
Shqipëria
nga torta që
Kosova i hoqi
Serbisë?**



RRUGA E DYSHIMTË E MALLRAVE SERBE

A PO BËHET MAQEDONIA TRAMPOLINË E SERBISË?



Mbi një muaj zgjasin kontrollet e përforcuara të autoriteteve të Kosovës nën dyshimin se bëhet fjalë për riekport të miellit nga Serbia, përmes Maqedonisë në Kosovë. Mullisët në Maqedoni ankohen se kanë dëme të mëdha nga pritja e kamionëve në kufi

Nga beteja ligjore, në fushëveprimin praktik

Shkup, 21 shkurt - Ligji për përdorimin e gjuhëve u miratua në fillim të vitit 2018, ndërsa pas peripetive të kohabitimit institucional midis Parlamentit dhe Presidentit të shtetit, ligji në fjalë u publikua më 14 janar 2019 në "Gazetën zyrtare, nr.7/2019". Shpallja e ligjit për shkak të refuzimit të presidentit për ta nënshkruar Dekretin, për herë të parë në historikun juridiko-politik pas pavarësimit të vendit u realizua me

fusnotë. Ligji për përdorimin e gjuhëve në nenin 13 dhe 14 parasheh të drejtën e përdorimit të gjuhëve edhe për qytetarët që flasin gjuhë tjetër më pak se 20% si dhe alfabetin e gjuhës së tyre për të dhënat personale që shënohen në letërnjoftimet dhe formularin e dokumentit të udhëtimit dhe fletudhëtimit, por me kërkesë të tyre. Ndërsa komunave u lihet mundësia që me Statut të rregullojnë...



EDITORIAL

PAQJA POLITIKE QË PI UJË NË BURIMET E KRIMINELËVE!



Emin AZEMI

Vetëm një drejtësi që e kthen Gruevskin në shtëpi, është e denjë të quhet drejtësi. Gjithçka tjetër është teatër, me maska të huazuara në karnavalet e lira të politikës së ditës

Parmbrëmë u arrestua ish-kryeparlamentari Trajko Velanovski. Ai dyshohet se bashkë me disa të tjerë nga partia e tij, kanë organizuar ngjarjet e përgjakshme në Parlament, më 27 prilli 2017. Por dyshimet nuk përfundojnë me kaq. Po del se kryeorganizatori i kësaj skeme kriminale, që kishte si synim pengimin e ndërimit të pushtetit pas zgjedhjeve parlamentare, të jetë, askush tjetër, po azilantit të përvuajtur që në Bukuresht u prezantua si i ndjekur nga regjimi i Shkupit. Ai po i ikte drejtësisë, duke kaluar male e fusha nëpër Shqipëri, pasi një gjykatë e Shkupit e ngarkonte atë për dallavere gjatë blerjes së një mercedesi zyrtar që kishte kushtuar mbi 600 mijë euro. Kjo akuzë qesharake, e bëri në fakt Gruevskin të paraqitet si viktimë në mediat Perëndimore, të cilat nuk po e kuptonin se si është e mundur të ngrihet kaq shumë pluhur për një mercedes të kushtueshëm, që paska dëmtuar arkën e shtetit, ndërkohë që dëmet tjera qindramilionëshe ende s'ishin procesuar në gjykatë.

I dyshuari tjetër si organizator i 27 prillit është shumë i njohuri Nikolla Boshkovski ("koka" e përgjimeve) i cili së bashkë me Goran Grujoski, (ish-eprorin e Drejtorisë së Pestë) tashmë një kohë të gjatë gjenden në Greqi, si azil politik.


Çka po ndodhë me drejtësinë në Shkup? Ngjarjet e 27 prillit kanë ndodhur gati para dy viteve dhe ide e kujt ishte që të pritët kaq kohë dhe të mos arrestohen organizatorët kryesorë të këtyre ngjarjeve. Nëse Gruevski iku ashtu si iku, ndonëse askush nuk beson se ajo ishte ikje klasike, pse u desh që detajet kryesore rreth 27 prillit të shpalosen kaq vonë. Kush kënd po e kursen?

Paqja (politike) në shtëpi, po ruhet duke shkelur me dy këmbë mbi parimet e së drejtës, pa të cilat shteti që ka si synim BE-në dhe NATO-n, nuk mund të bëjë asnjë hap. Por, një drejtësi që i ikin krerët e organizimeve kriminale, e ka vështirë të vendos paqe të vërtetë shoqërore në shtet, atëherë kur kastat politike mundohen të bëjnë pazare për mbijetesë. Nëse është kështu, i bie që të gjithë ne të jemi pengje të kësaj logjike që drejtësinë e zëvendëson me kontrabandë politike, nga e cila vështirë të shpëtojme.

Paqja politike që pi ujë në burimet e kriminelëve, nuk është paqe, por rrezik permanent që kërcënon lirinë e çdonjërit prej neve. Politikanët që premtojnë reforma, mund të vazhdojnë kështu sepse pa premtime nuk mund të fitojnë vota, por ata nuk mundet makiazhin të na e shesin si reformë.

Vetëm një drejtësi që e kthen Gruevskin në shtëpi, është e denjë të quhet drejtësi. Gjithçka tjetër është teatër, me maska të huazuara në karnavalet e lira të politikës së ditës.

QYTETARËT U "INTEGRUAN" NË BE PARA SHTETEVE TË TYRE



"Integrimi" emigruet i periferisë Europiane. Ballkanit i iku çereku i popullsisë. Deri në integrimin e tij në BE, do i ngel vetëm gjysma. Rajoni do anëtarësohet; por, më shtete të zbrazëta. Qytetarët u treguan më të shpejtë: u 'integruan' në BE- para shteteve të tyre", ka shkruar një status në Facebook, profesori universitar, Blerim Reka.

DIASPORA, DEFEKTET E ORGANIZIMIT GLOBAL!

"Jemi para Samitit të Diasporës ku secili shtet do të duhej ti kishte perfaqësuesit e vet, që do flasin për përvojat e organizimit të diasporës së tyre prej nga vijnë! Mirë është të flasim e bëjmë projekte se si duhet organizuar diaspora shqiptare edhe në nivel botëror, por si një rregull i pashkruar qëndron fakti se, secili nga ne që dëshiron të inicioj organizime të diasporës në nivel kontinentesh e të botës, duhet s'pari të merret me organizimin e diasporës së shtetit ku jeton! Mendoj se s'pari duhet të organizohemi në baza kombëtare si Bashkësi Shqiptare (Komunitete) në shtetet ku jetojmë, e tek më pas të merremi me kontinentet e me botën! Nuk e kuptoj si mundet dikush të merret me organizime në nivel kontinentesh e bote, kur nuk ka bërë dhe nuk bënë asgjë për organizimin e diasporës në shtetin ku jeton?! Si është e mundur që dikush që nuk ka arritur ta organizoj as edhe një komunë në shtetin ku jeton, të niset në Samitin e Diasporës në Tiranë, me idenë se do të mbaj atje ligjëratat se si duhet të organizohet diaspora në nivel botëror! No comment!", ka shkruar një status në Facebook, Ahmet Asani, kryetar i Fondit të shoqatave kulturore shqiptare në Zvicër.

LULËZIMI I PORTALEVE TË VOCKLA PARA ZGJEDHJEVE



"Pjesa më argëtuese e jetës më doket kjo e lulëzimit të portaleve të vockla para zgjedhjeve. Gjak janë kah bahen ndërmjet vete ca portale të vockla të PDK-së me të Nisma-s. Megjithatë, simpatia ime në këto momente shkon për portalin e Nisma-s, te quajtur Pista News. I sosi me spekulime rivalët politikë", ka shkruar një status ironik në Facebook, gazetari nga Prishtina, Parim Olluri.

MEDIACitate

JUNCKER: BALLKANI NDËRMJET BE-SË, PAQES E LUFTËS



Vendet e Ballkanit perëndimor duhet të kenë perspektivë reale të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, në të kundërtën ekziston rreziku i kthimit në vitet e 90-ta të shekullit të kaluar, ka deklaruar dje në Bruksel kryetari i Komisionit Evropian, Jena Claude Juncker pas takimit me kryetarin slloven Borut Pahor. Perspektiva e vendeve anëtare të Ballkanit perëndimor duhet të jetë reale, përndryshe nëse këto vende nuk bëhen anëtare të BE-së, rrezikojmë kthimin në të 90-tat. Mendoj se kjo është çështje e luftës ose paqes", ka thënë Juncker në konferencën e përbashkët me Pahorin.

Ai ka paralajmëruar se do të bëjë gjithçka që të arrihet takimi në krye i Iniciativës së tri deteve, të cilin e organizon kryetari i Sllovenisë në fillim të qershorit në Lubjanë. "Në tërësi e mbështes këtë iniciativë", ka thënë Juncker, i cili në vitin 2018 ka marrë pjesë në samitin e Iniciativës në Bukuresht. Inicitaiva e tri deteve, siç vë në dukje agjencia Hina, është projekt i përbashkët kroat-polak, i nisur në citin 2016 në takimin në Dubrovnik, ndërsa ka për qëllim forcimin e bashkëpunimit tregtar, të infrastrukturës, në energjetikë e politik në hapësirën ndërmjet deteve Adriatik, Baltik e të Zi. Iniciativa tubon 12 shtete të BE-së: Kroacinë, Poloninë, Hungarinë, Çekinë, Sllovakinë, Rumaninë, Bullgarinë, Lituaninë, Letoninë, Estoninë, Slloveninë e Austrinë.

(Gazeta Metro, 21 shkurt)

NËSE NUK E KENI DITUR...

SISTEMI I SIGURISË SË GOOGLE MUND T'JU SPIUNOJË!

Google është gjetur në mes të një skandali privatësie, pasi të mërkurën u zbulua se ka një mikrofon të instaluar në sistemin e alarmit Nest Secure. Mikrofonin nuk është në listën e specifikacioneve të produktit Nest, e cila është e dizajnuar që të kujdeset për sigurinë dhe të mbajtur të fshehtë të dhënat personale. Kjo u

zbulua pasi përditësimet e reja të Google lejojnë që kjo pajisje të kontrollohet përmes zërit. Por, në mënyrë që ky përditësim të ri të funksionojë, kërkohet një mikrofon që ka qenë i instaluar prej fillimit. Google, pasi kërkoi falje, tha se kjo ishte një lëshim dhe ishte mbajtur sekret aksidentalisht.

ZAEVI TAKOI KRYETARIN E BESËS, BILALL KASAMI

DISA PROPOZIME PËR KANDIDAT TË PËRBASHKËT

Zaevi tha se vendimin për kandidatin për president duhet ta sjellin para Kongresit, gjegjësisht javën e ardhshme, ndërsa nuk dëshiroi të komentojë se cili është kandidati më i përshtatshëm për partinë shqiptare



Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 21 shkurt - Kryeministri Zoran Zaev pas takimit me kryetarin e Lëvizjes BESA deklaroi se kanë biseduar për disa propozime për kandidat të mundshëm të përbashkët presidencial në zgjedhjet e ardhshme për president të shtetit. "Në takim me Kasamin dhe shoqërimin e tij e prezantuaam kërkesën tonë për pjesëmarrje të përbashkët në zgjedhje, përmes analizës së detajuar dhe mbështetjes së kandidatit, emër i cili është i pranueshëm për të gjithë për shkak të vlerës që e marrin të gjithë qytetarët dhe Republika e Maqedonisë së Veriut, të gjindet një person i cili do të jetë president i të gjithë qytetarëve, president i mirë në frymën e asaj që është ardhmëria e vendit dhe ky është integrim i shpejtë në NATO dhe marrje të datës për negociatat me

BE-në, por edhe natyrisht për çështjet aktuale siç është ekonomia, reformat dhe të ngjashme", tha Zaev. Ai shtoi se nga Besa, si parti opozitare, kanë lënë mundësi edhe për pjesëmarrje të pavarur për çka, thotë, ka mirëkuptim dhe se i shqyrtojnë të gjitha variantet.

"Besoj se nuk është e mundur,

se mund të arrihet me mbështetje në një emër i cili pa dallim nëse është burrë ose grua, pas të cilit do të qëndronin të gjithë qytetarët dhe me këtë edhe ne subjektet politike do të merrnim qëndrim për mbështetjen e tij si kandidat për president të shtetit. Por, natyrisht, vendimet do të sillen në bazë të

emrave, në bazë të personaliteteve të cilat, në pajtim me analizat që tani më ekzistojnë në shtet, ndërsa i bëjnë pothuajse të gjithë subjektet, do të japin argument të mirë për marrjen e qëndrimit së pari për konceptin nëse qëndrohet pas kandidatit të përbashkët dhe natyrisht më pas edhe aletarnati-

vat tjera", tha Zaev, duke shprehur qëndrim se është mirë atë që e bëjnë dhe se ka shanse të mëdha që shumë subjekte politike në shtet të qëndrojnë së bashku pas kandidatit të përbashkët.

Në ndërkohë, Kasami ka thënë se BESA nuk do të mbështet kandidat për president pa kurrfarë kushtëzimi. "Përkundrazi, do të mbështesim kandidat i cili do të kontribuoj në relaksim dhe marrëdhëniet ndëretnike. Ne si Lëvizje BESA e pamë të arsyeshme që të dëgjojmë mendimin e Kryeministrit rreth konceptit të presidentit dhe emrave konkret. Si Lëvizje BESA, si parti opozitare kemi shumë opsione të cilat i diskutojmë dhe këto opsione sigurisht do të varen nga emrat të cilët janë serioz në këtë kombinatorikë dhe sigurisht në ditët në vijim ne do të dalim me qëndrimin tonë se cili do të jetë opsioni që do ta përkrah Lëvizja Besa në raundin e parë dhe të dytë", deklaroi Kasami. Në pyetje të gazetarëve kur të pritet vendimi përfundimtar për zgjedhjen e kandidatit konkret, Zaev tha se për këtë si parti, vendimin duhet ta sjellin para Kongresit, gjegjësisht javën e ardhshme. Ai nuk dëshiroi të komentojë se cili është kandidati më i përshtatshëm për partinë shqiptare dhe theksoi se sublimitin nga të gjitha analizat do ta nxjerr në shesh, presidenti i ardhshëm i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

VENDIT I DUHET PRESIDENT I TË GJITHËVE

Kryetari i Komisionit për Çështje Evropiane të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Artan Grubi, dje pati takim me ambasadorin e Republikës së Francës në Maqedoninë Veriore, Kristijan Timonie. Në takim, si citohet në njoftim, Grubi, duke e falënderuar për përkrahjen e deritanishme për proceset tona eurointegruese, theksoi se vendi me vendosshmëri hapëron drejt anëtarësimit në strukturat euroatlantike pas detyrave të kryera në lidhje me miratimin e amendamenteve kushtetuese, me të cilat u implementua Marrëveshja e Prespës, si dhe pas

ratifikimit të Marrëveshjes për fqinjësi të mirë me Bullgarinë. Grubi gjithashtu ka folur edhe për zgjedhjet presidenciale në vend, si dhe negociatat në mes LSDM-së dhe BDI-së, por edhe për ndodhitë aktuale në vend. Vendit i nevojitet kandidat i cili i bashkon të gjithë qytetarët, të gjitha komunitetet dhe e kërkon votën nga të gjithë, e jo kandidat partiak monoetnik. Ambasadori Timonie i përshëndeti arritjet pozitive në vend, si hap i rëndësishëm në rrugën drejt BE-së dhe NATO-së dhe shprehu gatishmërinë e Francës për bashkëpunim dhe ndihmë në proceset eurointegruese nga Franca.

Në Greqi vetëm me pasaportë, hiqet "fleta e bardhë"

Gjevgjeli, 21 shkurt - Fletët e bardha në të cilat deri dje policët kufitarë grekë na vendosnin vula për hyrje në vendin e tyre prej të mërkurës në mesnatë shkuan në histori. Tani, gjatë hyrjes në Greqi, qytetarët tanë kufirin e Maqedonisë dhe të Greqisë e kalojnë vetëm me pasaporta në të cilat në dalje të vendit policët tanë kufitarë u vendosin vula në të cilën në gjuhën maqedonase, angleze dhe franceze shkruan se dokumenti është pronë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa policët grekë për herë të parë vendosin vula në pasaporta. Rregullat e reja nga Marrëveshja e Prespës shërbimet kufitare greke filluan t'i zbatojnë pas një jave pasi në vendkalimin kufitar "Bogorodicë" u vendos tabela me emrin e ri kushtetues të vendit tonë. Sipas paralajmërimeve, karta identiteti dhe dokumente udhëtimi me emrin e ri kushtetues në vend do të fillojnë të jepen nga fundi i këtij viti.

TAKIM I MINISTRAVE PËR ÇËSHTJE EVROPIANE

BALLKANI I GJASHTË MINISTRAVE, TRE SHQIPTARË DHE TRE SERB

Shkup, 21 shkurt - Se sa të shpërndarë janë shqiptarët, tregojnë edhe fotot e takimit të Ministrave për Çështje Evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor, organizuar nën ombrellën e Gernot Blumel, ministrit Federal për Çështje Evropiane të Austrisë në zyrën e Kancelarit Sebastian Kurc, tregon një detaj interesant. Nga gjashtë ministrat e Ballkanit, tre janë shqiptarë: Bujar Osmani, zëvendëskryeministër për eurointegrimin i Maqedonisë së Veriut, Dhurata Hoxha, ministre e integritetit e Republikës së Kosovës, si dhe Sokol Deda, zëvendësministër për Evropë i Republikës së Shqipërisë.

"Nuk ekziston alternativë për ardhmërinë e vendeve të Ballkanit Perëndimor, përveç anëtarësimit në BE dhe NATO. Kjo paraqet ardhmëri të përbashkët, mundësi të vetme për Evropë stabile, të sigurt dhe me prosperitet", tha Osmani në këtë takim. "Të gjithë ne, vendet kandidate për anëtarësim në BE, kemi ambicie dhe qëllim të përbashkët për të qenë pje-



së e BE-së, sepse vetëm një Ballkan i qëndrueshëm, i sigurt dhe i begatë është garancë e fortë për një Evropë të qëndrueshme, të sigurt dhe të begatë në tërësi", theksoi Osmani në takim. Ai theksoi se vendet e Ballkanit Perëndimor, jo vetëm gjeografikisht por edhe politikisht dhe kulturalisht, kanë qenë gjithmonë pjesë e Evropës. "Në rajon ka një realitet të ri të quajtur Republika e Maqedonisë së Veriut. Ky është vendi i cili pa dyshim bëhet anëtar i 30-të i

Aleancës së NATO-s, i cili ka pritur reale për të filluar negociatat për anëtarësim në Bashkimin Evropian këtë vit; ky është vendi i cili po shndërrohet në shembull për demokraci të organizuar funksionale, multikulturore, multietnike dhe multigjuhësore, theksoi Osmani, duke potencuar se vendi nuk ka më asnjë çështje të hapur me fqinjët e saj, por edhe që ka arritur ti mbyllë të gjitha çështjet kryesore të hapura brenda, në shtepi.

Në këtë takim ka qenë edhe ministrja serbe për Integrim evropian, Jadranka Joksimović, ministri për Evropë i BeH, Igor Crnadak, si dhe Zoran Janković, zëvendësministër për Evropë i Malit të Zi. Në ndërkohë, nikoqir i takimit ka qenë ministri Federal për Çështje Evropiane të Austrisë, Gernot Blume, si dhe ministri për Evropë i Rumanisë, Viktor Mikula, njëherësh kryesues i BE-së për gjashtë muajt e ardhshëm.

Në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi, të gjitha institucionet kompetente obligohen që të miratojnë aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve, ndërkohë deri në gjashtë muajsh, institucionet obligohen t'i zbatojnë obligimet e theksuara në nenin 7 që ka të bëjë me tabelat-emrat e institucioneve dhe vultat e tyre

Koha

Destan JONUZI

Shkup, 21 shkurt - Ligji për përdorimin e gjuhëve u miratua në fillim të vitit 2018, ndërsa pas peripetive të kohabitimit institucional midis Parlamentit dhe Presidentit të shtetit, ligji në fjalë u publikua më 14 janar 2019 në "Gazetën zyrtare, nr.7/2019". Shpallja e ligjit për shkak të refuzimit të presidentit për ta nënshkruar Dekretin, për herë të parë në historikun juridikopolitik pas pavarësimit të vendit u realizua me fusnotë.

Ligji për përdorimin e gjuhëve në nenin 13 dhe 14 parasheh të drejtën e përdorimit të gjuhëve edhe për qytetarët që flasin gjuhë tjetër më pak se 20% si dhe alfabetin e gjuhës së tyre për të dhënat personale që shënohen në letërnjoftimet dhe formularin e dokumentit të udhëtimit dhe fleudhëtimit, por me kërkesë të tyre. Ndërsa komunave u lihet mundësia që me Statut të rregullojnë përdorimin e gjuhës të cilën e flasin më pak se 20% e qytetarëve në komunën përkatëse.

ZBATIMI NË PRAKTIKË

Për zbatimin e ligjit për përdorimin është paraparë që të themelohet edhe Agjencia për Zbatimin e Ligjit të gjuhëve. Zëdhënësi i Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, Muhamet Hoxha, njofton se konkursi për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë, tanimë është mbyllur dhe se pritet që Qeveria të emëron drejtorin e këtij institucioni të ri.

"Konkursi është shpallur më 7 shkurt dhe është mbyllur me 13 shkurt, gjithsej për këtë pozitë kanë aplikuar 19 kandidatë. Pas përfundimit të konkursit shërbimet kompetente do të shqyrtojnë kandidaturat dhe më pas do të vendos komisioni kadrovik i Qeverisë. Komisioni kadrovik i Qeverisë duhet të vendos deri ditën e martë dhe të sjell propozim në Qeveri, ku do të shqyrtohet mundësia e emërimit në bazë të dispozitave ligjore. Në këtë fazë ku vetëm se janë shpallur zgjedhjet presidenciale, Qeveria do të konsultohet me organet gjegjëse, ndoshta edhe në rast nevojë edhe me Komisionin për anti-korrupsion, se a ka të drejtë që të

ZBATIMI I LIGJIT TË GJUHËVE

NGA BETEJA LIGJORE, NË FUSHËVEPRIMIN PRAKTIK



emërojë në këtë periudhë drejtorin apo jo. Nëse nuk ka asnjë pengesë ligjore atëherë drejtori i Agjencisë për zbatimin e ligjit të gjuhëve do të emërohet në seancën e radhës. Vendimi do të merret në përputhje me dispozitat ligjore", njoftoi Hoxha. Hoxha bëri të ditur se drejtorin për Agjencisë për Zbatimin e Ligjit të gjuhëve e emëron dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

"Në këtë fazë nuk mund të emërohet ushtrues detyre drejtor për arsye se bëhet fjalë për një institucion të ri, i cili është formuar në bazë të ligjit për përdorimin e gjuhëve. Drejtori i ri do të ketë për obligim të bënë edhe riorganizimin e institucionit të ri me sistematizimin e vendeve të reja të punës dhe të gjitha aktet tjera të nevojshme për funksionimin e institucionit. Do të bëhen analiza do të shikohet mundësia që të shfrytëzohet kadri aktual, por varësisht prej analizave do të merren edhe vendime për punësimin e kuadrove shtesë", deklaroi Hoxha për KOHA. Agjencia për zbatimin e ligjit të gjuhëve ka kompetenca të përcaktuara në mënyrë të qartë në

nenin 19 të ligjit, ndër të tjera do të jetë kompetente për lekturimin e të gjitha akteve që do të botohen në Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ndërkohë, që Inspektorati i cili në bazë të dispozitave të Ligjit për përdorimin e gjuhëve do të mbikëqyrë ecurinë e zbatimit të ligjit, do të jetë një organ në vete i themeluar nga Ministria e Drejtësisë, por me një ligj të posaçëm. Nga Qeveria për gazetën KOHA thonë se tanimë Qeveria i ka kërkuar Ministrisë së Drejtësisë që në afat prej 15 ditësh ti dorëzojë propozim ligj për themelimin e Inspektoratit për përdorimin e gjuhëve. Nga ana tjetër ministrja Renata Deskoska i tha gazetës KOHA se të punësuarit në këtë ministri vetëm se kanë filluar me punë për hartimin e ligjit për Inspektoratin. "Jemi në fazën e përgatitjes së Ligjit. Të punësuarit në ministri kanë filluar me punë. Inspektorati duhet të fillojë me punë për 6 muaj", deklaroi Deskoska.

IMPLEMENTIMI KËRKON KOHË

Juristi, Qenan Aliu vlerëson se implementimi i këtij ligji me kapacitet të plotë kërkon shumë vite.

"Implementimi faktikisht do të fillojë pas një viti e gjysmë. Nuk do të has në gatishmëri të plotë për zbatim nga maqedonasit. Gjohat e parashikuara janë përcaktuar por zbatimi i tyre është i vështirë. Ndërkaq aktet nënligjore, duhet ta rregullojnë se si ligji do të zbatohet në seancat gjyqësore, para noterit, a do ta paguaj pala gjoja aktin e lëshuar në dy gjuhë apo tek përmbartuesit etj. Ka shumë sfida, nëse gjykata vendosë me precedentin e 1997, ligji do të bjerë dhe duhet nga fillimi procedura e miratimit etj.", deklaroi për gazetën KOHA, Qenan Aliu, jurist.

Profesoresha universitare, Besa Kadriu thekson se pas krijimit të tensioneve politike në Maqedoni, subjekte të reja politike që u krijuan, periudha e vitit 2016 e kënde, shënoi bujë edhe në ngritjen e shumë çështjeve politike rreth avancimit të të drejtave të shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë Veriore, ku në mes të tjerash u shënuar edhe një akt i rëndësishëm, elementi i zyrtarizimit të gjuhës në suaza të institucioneve qendrore dhe lokale. "Sigurisht, krahas zyrtarizimit, tanimë në vazhden edhe të implementimit

praktik, ka shumëçka që duhet të marrë trajtën e duhur. Fillimisht duhet formuluar edhe shumë shumë përmbytje të akteve t ndryshme në veprimtarinë e punës së organeve të administratës, të fillojnë të aplikojnë zbatimin praktik në aspektin përmbajtësor të akteve juridike në dygjuhësi sepse ky është tanimë një detyrim ligjor, për të cilin autoritetet duhet të marrin masa dhe sanksione në rast të mos realizimit ligjit në fjalë. Duhet të jemi optimistë që gjërat po fillojnë të lëvizin nga e mbara", thekson profesoresha Kadriu.

AFATET PËR ZBATIMIN E LIGJIT

Në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të gjitha institucionet kompetente obligohen që ti miratojnë aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji. Në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, institucionet obligohen ti zbatojnë obligimet e theksuar në nenin 7 që ka të bëjë me tabelat-emrat e institucioneve dhe vultat e tyre. Qeveria obligohet menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji të zhvillojë program për ngritjen e vetëdijes publike për zbatimin e këtij ligji. Ndërsa në afat prej një viti, dispozita e ligjeve tjera që tangojnë gjuhët do të harmonizohen me dispozitat e këtij ligji. Në rast të mosharmonizimit të dispozitave të këtij ligji, me dispozitat për gjuhët të ligjeve tjera, organet kanë për detyrë të zbatojnë dispozitat e këtij ligji. Si rezultat i tensionimit politik nga konstituimi i Qeverisë së re, me të cilën temë boshte atëherë ishte statusi i gjuhës shqipe, pas hyrjes në fuqi të tij, për qëllime të ndryshme pranë Gjykatës Kushtetuese janë ngritur disa iniciativa për vlerësimin e kushtetutshmërisë të këtij ligji, si dhe me iniciativë të qeverisë i njëjti është i dërguar edhe në Komisionin e Venedikut për mendim.

Ligji, shikuar në frymën e tij nuk cenon amendamentin kushtetues që trajton këtë sferë. I vetmi risk ka të bëjë me faktin, nëse edhe kjo përbërje e Gjykatës Kushtetuese do të zbatojë precedentin e një përbërje tjetër të viti 1997, e cila atëherë abrogoi një ligj i cili ishte i shpallur me Dekretin ku kishte firmosur kryetari i Parlamentit edhe në vend të Presidentit, e që në rastin e fundit shpallja e ligjit ka të bëjë me FUSNOTË për shkak të shkeljes së dispozitës kushtetuese nga kryetari i vendit duke refuzuar ta dekretojë.

BASHKË ME BULLGARINË FESTOHET SAMOILI, NAUMI DHE KLIMENTI

Është arritur pajtueshmëria për shënimin e festës së përbashkët të mbretit Samoili, Shën Klimentit dhe Shën Naumit në takimin dyditor të Komisionit të përbashkët për çështje historike dhe arsimore mes Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Bullgarisë që përfundoi të mërkurën mbremë në Shkup. "Pas debateve të gjata, Komisioni i përbashkët arriti pajtueshmëri t'u japë rekomandim qeverive të të dy shteteve se ekzistojnë mjaft elemente për festim të përbashkët të Shën Klimentit, Shën Naumit dhe mbretit Samoili, si urë ndërtimi të marrëdhënies të

ndërsjella miqësore, në frymën e Marrëveshjes për miqësi dhe fqinjësi të mirë", qëndron në kumtesën nga Instituti për histori nacionale. Në takim është shqyrtuar mundësia për festim të përbashkët të disa personaliteteve historike të cilët janë të rëndësishëm për të dy shtetet, përdërisa diskutimi për librat e historisë ishte shtyrë për takimin e ardhshëm. Ky është takimi i katërt i Komisionit të përbashkët të Maqedonisë dhe Bullgarisë për çështje historike dhe arsimore, që u formua në pajtim me Marrëveshjen për fqinjësi të mirë mes dy vendeve.

Pavarësisht se të dyshuarit Gruevski dhe Boshkovski gjenden në arrati, gjegjësisht në Hungari dhe Greqi, nga Prokuroria për krim të organizuar kanë paralajmëruar se do të zgjerojnë kërkesën për ekstradim. Prokurorja Villma Ruskovska me këtë rast deklaroi se nuk pret që autoritet greke të pengojnë procedurën e ekstradimit. Një gjë e tillë, ajo tha se vlen edhe për Gruevskin

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 21 shkurt - Përmes thirrjes publike dhe organizimit të brendshëm të VMRO-së, Nikolla Gruevski, i dënuar në rastin "Tank" dhe i dyshuar në më shumë procese tjera gjyqësore, mendohet se është organizatori kyç i ngjarjeve të dhunshme të 27 prillit. Shefja e Prokurorisë për krim të organizuar, Villma Ruskovska, gjatë prezantimit të detajeve për hetimet e organizatorëve të 27 prillit, tha se i dyshuari N.G në koordinim me anëtar tjerë të partisë dhe këshillat vendor e lokal e ka koordinuar turmën e dhunshme në Parlament.

Ish-kryeministrin, tash më azilant, Gruevski, në këtë organizim e kanë ndihmuar Mile Janakievski dhe Spiro Ristovski, të cilëve Gjykata Penale e Shkupit, ju ka shqiptuar masën e paraburgimit 30 ditë. Të dyshuar tjerë si organizator janë edhe ish-kryeparlamentari Trajko Veljanovski. Ai, mbrëmjen e 20 shkurtit, pas intervistimit në Gjykatë, tha se është turp të mendohet se ai e ka organizuar 27 prillin, kur për dhjetë vite me radhë ka qenë në krye të Parlamentit. Për shkak të imunitetit të deputetit,

ZGJEROHEN HETIMET PËR DHUNËN NË PARLAMENT

GRUEVSKI DHE VMRO ORGANIZATORË TË 27 PRILLIT



Gjykata nuk ka mundur t'i shqipton masën e paraburgimit. I dyshuari i pestë si organizator i 27 prillit është shumë i njohuri Nikolla Boshkovski, ("koka e përgjimeve") i cili së bashkë me Goran Grujoski, (ish-eprorin e Drejtorisë së Pestë) tashmë një kohë të gjatë gjenden në Greqi, si azil politik.

A DO TË EKSTRADOHET NIKOLLA GRUEVSKI?

Pavarësisht se të dyshuarit Gruevski dhe Boshkovski, gjenden në arrati, gjegjësisht në Hungari dhe Greqi, nga Prokuroria për krim të organizuar kanë paralajmëruar se do të zgjerojnë kërkesën për ekstradim. Prokurorja, Villma Ruskovska me këtë rast deklaroi se nuk pret që autoritet greke të pengojnë procedurën e ekstradimit. Një gjë e tillë, ajo tha se vlen edhe për Gruevskin.

"Ligji për amnistia për rastin e 27 prillit nuk vlen për organizatorët e kësaj ngjarje. Amnistia e dhënë në këtë rast nuk ishte për veprën penale, por për disa veprime të akuzuarve. Vlerësoj se nëse nuk

ishin hapur dyert e Parlamentit, nuk do të kishte ndodhur 27 prilli", tha Ruskovska.

Tutje, në takimin me gazetarinë në Prokurorinë Publike, u tha se fillimi i hetimeve për organizatorët e 27 prillit nuk është iniciuar vetëm në bazë të deklaratës së Aleksandar Vasilevskit Ninxhës. Gjatë mbrojtjes së tij i akuzuari Ninxha, javë më parë, tha e gjithë ngjarja e 27 prillit është udhëhequr nga selia e VMRO-së në Shkup. Sipas tij në aty ka pasur një shtab, ku kanë qëndruar Mile Janakievski, Spiro Ristovski, Mitko Çavko dhe të tjerë.

"Në asnjë moment nuk i fillojmë hetimet vetëm në bazë të një deklaratë, të cilën në këtë rast e dha një i akuzuar në procedurë gjyqësore. Mbase bëhet fjalë për procedure hetimore nuk mund të shpallim se cilat janë provat tjera që i disponojmë kundër të dyshuarve si organizator të 27 prillit", shtoi prokurorja Ruskovska. Ndryshe, përveç Janakievskit dhe Spirovskit, dy ish-ministra të qeverisë Gruevski, në paraburgim për disa muaj me radhë qëndron ish-drejtori i

Drejtorisë për Siguri dhe Kundërbulim, Vlladimir Atanasovski.

GJYKATA KËRKON SHFUQIZIMIN E IMUNITETIT TË TRAJKO VELJANOVSKIT

Gjykata Penale e Shkupit, të enjten deri te Parlamenti i Maqedonisë së Veriut, ka parashtruar kërkesën për shfuqizimin e imunitetit të deputetit Trajko Veljanovski, i dyshuar si organizator i ngjarjeve të 27 prillit. Përpos njoftimit të gjykatës, lajmin e kanë vërtetuar edhe nga kabineti i kryeparlamentarit Talat Xhaferi. Procedura ligjore parasheh që kjo kërkesë tashmë ti delegohet Komisionit parlamentar për çështje imuniteti të deputeteve. Me komisionin në fjalë kryeson deputeti nga radhët e LSDM-së, Pavle Bogevski. Pjesë e këtij Komisioni është edhe veti i dyshuari Veljanovski. Ndryshe, Trajko Veljanovski, në procesin gjyqësor për 27 prillin në Gjykatë u paraqit në cilësinë e dëshmitarit, të cilën e propozoi ish-sigurimi i tij, i akuzuari Goran Gjoshevski.

Xhaferi e kthen në gjykatë kërkesën për Veljanoskin

Shkup, 21 shkurt - Për shkak të referimit të një neni të gabuar nga Ligji, kryetari i Parlamentit të Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi do ta kthejë deri tek Gjykata penale kërkesën për marrjen e imunitetit të deputetit, ish-kryetarit të Parlamentit, Trajko Veljanovski. Nga shërbimi parlamentar për media thonë se në momentin kur do të arrijë kërkesa e re nga gjykata, do të vepohet sipas të gjitha afateve nga Rregullorja. Kërkesa nga Gjykata penale në Shkup për marrjen e imunitetit të deputetit të Veljanoskit, arriti rreth mesditës në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Pas marrjes së kërkesës së re, Xhaferi duhet të dorëzojë deri tek Komisioni për çështje të rregullores, imunitetit dhe mandatit. Sipas Rregullores, Komisioni është i obliguar ta shqyrtojë kërkesën dhe në afat prej dy ditëve të dorëzojë raport deri tek kryetari i Parlamentit. Me Komisionin për çështje të rregullores, mandatit dhe imunitetit kryeson deputeti Pavle Bogoevski. Pas raportit të marrë nga Komisioni, Parlamenti më së voni në afat prej tre ditëve duhet të vendos për kërkesën e gjykatës në seancë plenare. vendimi për marrjen e imunitetit sillet me shumicë të thjeshtë nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Përbërja aktuale e deputetëve deri më tani në kërkesë të gjykatës solli vendime për marrjen e imunitetit të deputetëve Nikolla Gruevski, Lupço Dimovski, Kërsto Mukovski, Jovan Tarçullovski, Zhaklina Peshevska, Luben Arnaudov dhe Sasho Vasilevski.

Deri më tani nuk kemi të dhëna kush e ka përgjegjësinë për aksidentin në fjalë, është shprehur kryeprokurori Lubomir Jovevski, i cili ka njoftuar se një pjesë e materialeve që prokuroria i ka kërkuar nga kompania 'Durmo Turs' janë siguruar, kurse të tjerat duhet të dorëzohen në mënyrë plotësuese

Shkup, 21 shkurt - Hetimet për ngjarjen tragjike të "Laskarcës" dhe procedimin e padive të ngritura nga MPB-ja, për përdorimin e gjuhës e urrejtjes, Prokuroria Publike ende është duke i shqyrtuar. Kryeprokurori Lubomir Jovevski, duke u

TRAGJEDIA NË LASKARCË ENDE AKTUALE

PAS PËRFUNDIMIT TË HETIMEVE, DO TË DIHEN SHKAQET

përgjigjur në këtë temë tha se për momentin janë duke u realizuar më shumë ekspertiza dhe pasi që prokuroria ti siguron këto dëshmi të jep të dhëna konkrete. Ai, mes tjerash shtoi se brenda kësaj kohe janë intervistuar më shumë dëshmitar.

"Pas përfundimit të hetimeve do të japin përgjigje për arsyet se si ka ndodhur kjo tragjedi, eventualisht për përgjegjësinë penale të kryerësit apo kryerësve. Deri më tani nuk kemi këso të dhëna, kush e ka përgjegjësinë për aksidentin në fjalë. Njëherit, një pjesë e materialeve që prokuroria i ka kërkuar nga kompania 'Durmo Turs' janë siguruar, tjerat duhet të dorëzohen në mënyrë plotësuese. Shoferi i auto-

busit ndërkohë është marrë në pyetje, por kjo nuk nënkupton se nëse është nevoja përsëri nuk do ta ftojme për intervistim. Po ashtu, në mënyrë aktiv jemi duke i përcjellur paditë e MPB-së dhe gjithçka që lidhen me gjuhën e urrejtjes. Jemi duke vepruar", tha kryeprokurori Jovevski. Ndryshe, siç njoftoi prokurori shtetëror, Lubomir Jovevski, ata kanë njohuri se përmes rrjeteve sociale është kërcënuar shoferi i autobusit dhe familjarët e tij.

"Apeli im është që në këtë drejtim të respektohet prezumimi i pafajësisë. Ne ende nuk mundemi në mënyrë korrekte ta përcaktojmë përgjegjësinë e një personi të caktuar. Janë duke u mbledhur dëshmi

dhe dokumentet për këtë aksident komunikacioni. Kur ti sigurojmë ekspertizat dhe provat tjera ne do të sjellim vendim prokurorial", tha prokurori Jovevski.

Siç dihet tash më, javë më parë në autostradën Shkup-Tetovë, në rrethana ende të panjohura, një autobus i kompanisë "Durmo Turs" nga Gostivar u aksidentua dhe për pasojë humbën jetën 15 persona, të gjithë nga qyteti i Gostivarit dhe rrethinës, kurse mbi 30 tjerë u lënduar. Gjendja shëndetësore e një pjesë të të lënduarve ende mbetet në rrezik. Paralelisht me këtë ngjarje, në rrjetet sociale u shpërndanë shumë ngushëllime dhe apel për ndihmë. Mirëpo, në mesin e

këtyre postimeve ekzistonin edhe të tillë që ironizonin me ngjarjen. Një veprim të tillë siç dihet publikisht e bëri profesoresha universitare Biljana Vankovska, e cila profilin e saj në Facebook u shpreh: "Çfarë ironie tragjike: Karpallak!".

Ky qëndrim i saj për shumicën e qytetarëve shqiptar u kuptua si një mburrje me vdekjen e udhëtarëve, pikërisht në vendin Karpallak, kur në vitin 2001, dhjetë pjesëtar të forcave policore të MPB-së, humbën jetën në ballafaqimin e tyre me njësitë e UÇK-së. Megjithatë, fatkeqësia në këtë rast e tejkaloi aspektin etnik, për shkak se në mesin e 15 viktimave, gati se gjysma ishin joshqiptarë. (O.Xh)

Të dhënat nga policia tregojnë se gjatë vitit 2017, viktimit e trafikimit kanë qenë 202 migrantë, e gjatë 9-mujorit të parë të vitit 2018, 763 migrantë kanë qenë viktimit e trafikimit. Dikasteri i policisë së Maqedonisë së Veriut ka njoftuar se më 15 shkurt ka shkatërruar një grup kriminal, që ishte i përfshirë në trafikimin e migrantëve. Ky grup kishte transportuar migrantët nga kufiri i Greqisë, për në Kumanovë dhe Likovë dhe më pas për të kaluar ilegalisht në territorin e Serbisë

Shkup, 21 shkurt - Organizatat që merren me përkujdesjen e migrantëve, kanë përsëritur aksionin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, për shpërbërjen e grupit të organizuar për trafikimin e migrantëve. Ata kanë theksuar, se në bazë të informacioneve që posedojnë, migrantët për të hyrë në territorin e Maqedonisë së Veriut ilegalisht dhe me qëllim që të shlyejnë borxhet ndaj trafikantëve, jo rrallë janë detyruar të bëjnë punë nga më të ndryshmet. Nga Ministria e Punëve të Brendshme, për Radion Evropa e Lirë kanë thënë se gjatë vitit 2018 është rritur dukshëm numri i migrantëve

“RUTA BALLKANIKE” NUK NDALET LEHTË

DYFISHOHET TRAFIKIMI ME MIGRANTË



që kanë tentuar ilegalisht të kalojnë nëpër territorin e Maqedonisë së Veriut.

Përderisa gjatë 2017, 4129 persona janë penguar të hyjnë ilegalisht në vend, vetëm në 9-mujorin e parë të vitit 2018, kjo shifër është trefishuar, përkatësisht, 13.141 migrantë janë penguar që të hyjnë jashtëligjshëm në Maqedoninë e Veriut. Ndërkaq, të dhënat nga policia tregojnë se gjatë vitit 2017, viktimit e trafikimit kanë qenë 202 migrantë, e gjatë 9-mujorit të parë të vitit 2018, 763 migrantë kanë

qenë viktimit e trafikimit. Dikasteri i policisë së Maqedonisë së Veriut ka njoftuar se më 15 shkurt ka shkatërruar një grup kriminal, që ishte i përfshirë në trafikimin e migrantëve. Ky grup kishte transportuar migrantët nga kufiri i Greqisë, për në Kumanovë dhe Likovë dhe më pas për të kaluar ilegalisht në territorin e Serbisë.

Përderisa nga organizata joqeveritare Legis, që merret me migrantët, bëjnë të ditur se gjatë vitit 2018 janë regjistruar 4 mijë e 500 migrantë, të cilët ilegalisht e kanë

kaluar territorin e Maqedonisë së Veriut. Po sipas të dhënave të kësaj organizate, 3 mijë e 500 migrantë të tjerë, përmes territorit të Maqedonisë së Veriut, kanë kaluar përmes dy qendrave transitorie në Gjevgjeli, në kufi me Greqinë dhe në Tabanoc, që gjendet në kufi me Serbinë. “Një pjesë e migrantëve u paguajnë menjëherë para trafikantëve, që t’i ndihmojnë ta kalojnë territorin e Maqedonisë, por ata që nuk kanë para të mjaftueshme, shfrytëzohen për të kryer shërbime të caktuara për trafikantët”, thotë Jasmin Rexhepi, drejtues i organizatës Legis.

“Gjatë vitit 2018, migrantët kryesisht kanë qenë nga Irani, India, Pakistani, Bangladeshi, Afganistani dhe shtetet e tjera të Afrikës Veriore”, tregon Rexhepi. Nga policia kanë njoftuar se ndaj 21 personave janë ngritur aktakuza për vepra penale si “organizim i një grupi dhe inkurajim i kryerjes së akteve të trafikimit me qenie njerëzore”, “kontrabandim të migrantëve” dhe “ndihmë” për “kontrabandimin e migrantëve”.

Ecolog e hapur për trajnimin dhe punësimin e studentëve

Tetovë, 21 shkurt - Kompania Ecolog International, para absolventëve të Universitetit të Tetovës prezantoi mundësitë e trajnimeve dhe punësimeve që ofron kjo kompani për studentët të cilët janë në prag të diplomimit dhe janë njohës të mirë të gjuhës angleze. Përgjegjësi për rekrutim i kësaj kompanie, Mislim Hasipi tha se qëllimi i prezantimit të sotëm është thellimi i bashkëpunimit të ndërsjellë mes kompanisë Ecolog dhe institucioneve të larta arsimore, dhe se Kompania Ecolog është një mundësi e mirë për studentët që ata të rriten në aspekt profesional, social, ekonomik në bazë të profilit që e kanë ndërtuar gjatë studimeve. Prezantimi nga ana e kompanisë Ecolog ka të bëjë me njoftimin e absolventëve për mundësitë që Ecolog i ofron, si në aspekt të punës praktike ashtu edhe për mundësinë e punësimit me afat të gjatë për nevojat e projekteve që Ecolog ka gjithandej ku kjo kompani e ushtron veprimtarinë e saj. Absolventët e Universitetit të Tetovës por edhe studentët tjerë në këtë prezantim shprehën interesim të madh për ofertat e kompanisë Ecolog, njëkohësisht parashtuan dhe një sërë pyetje sh mbi mënyrën e aplikimit për punë, kriteret që duhet t’i plotësojnë për punësim, përzgjedhjen e kandidatëve, për faktin se sa u kushtohet rëndësi CV-ve të kandidatëve, njohjes së gjuhëve të huaja e kështu me radhë. Përndryshe, në këtë prezantim u vë në dukje fakti që kompania Ecolog International vepron në 36 vende të ndryshme të botës dhe punon me projekte në sfera të ndryshme, megjithatë fokusi kryesor i kësaj kompanie ngelet te burimet njerëzore që i ofrojnë institucionet akademike. (U.H)

TENTIMET PËR KALIM TË PALIGJSHËM TË KUFIRIT RRIEN PËR 60 PËR QIND

Zëvendëskryeministri për çështje evropiane, Bujar Osmani, dje u raportoi përfaqësuesve të vendeve anëtare për situatën me sigurinë e kufirit të Maqedonisë së Veriut pasi është mbyllur e ashtuquajtura Ruta Ballkanike. Sipas të dhënave zyrtare ka rritje drastike të tentimeve për kalim të paligjshëm të kufirit, por zëvendëskryeministri nuk deshi të tregojë nëse kjo është e lidhur në çfarë do mënyrë me tentimin e penguar për atentat, për të cilin njoftoi MPB-ja dhe ambasada amerikane kohë më parë. “Në tre muajt e fundit vërejmë tentime të rritura për kalim të paligjshëm të kufirit, prej rreth dy mijë rasteve të kalimeve të penguar të

paligjshme, që është rritje për 60 për në krahasim me vitin paraprak, 90 për qind e tyre nga Greqia, me ç’rast mund të thuhet se në pjesën më të madhe pengohen dhe Maqedonia vepron në kuadër të kësaj politike të përbashkët të BE-së”, tha osmani për MIA-n. Bëhet fjalë për gjithsej 1960 raste në nëntor, dhjetor të vitit 2018 dhe janar të vitit 2019. Osmani nuk pati mundësi të thotë nëse dhe sa luftëtarë nga vatrë luftarake nga Siria dhe Iraku janë kthyer në Maqedoninë e Veriut, e as nëse dhe sa kërkesa ka për kthim, as cila është strategjia e qeverisë për përballje me këta persona nëse kthehen në vend.

ASH E TETOVËS KËRKON DORËHEQJEN E MINISTRIT TË ARSIMIT NË VEND TË SHKOLLËS, FOTOJA E ADEMIT

Tetovë, 21 shkurt - Duke marrë parasysh që ministri Arbër Ademi ka kompetenca të mëdha duke marrë dhe rimarrë kompetencat Komunes së Gostivarit, Aleanca për Shqiptarët - Dega në Tetovë e pyet publikisht Arbër Ademin, se a ka kompetenca për të ndërtuar edhe shkollën fillore në Reçicë të Vogël që e premtuar partia e tij më shumë se 10 vite. Me një pres konferencë nga Reçica e Vogël, aty ku është premtuar prej vitësh ndërtimi i një shkollë fillore, ASH e Tetovës ka akuzuar se në Komunën e Tetovës,

përveçse nuk është planifikuar ndërtimi i asnjë shkolle, po bëhen edhe punësime me nepotizëm.

“Kryetarja Teuta Arifi le ti sqarorë opinionit dhe ministrit të saj se si e ka punësuar motrën e saj dhe pastaj se si të njëjtës ia ka dhënë postin e zëvendësdirjtorit në shkollën fillore ‘Istikball’. A është në dijeni ministri për këtë gjë? Apo ministri Arbër Ademi, nuk merr masa ashtu siç nuk mori asnjë masë kur profesoresha Arjeta Veliu u keqtrajtua me vite të tëra duke u larguar nga puna pa bazë

ligjore nga ana e drejtorisë së asaj shkolle. Vallë, ligjet pa bazë vlejné vetëm për opozitarët dhe jo për ata të cilët janë në pushtet. Ministri Arbër Ademi duhet të merr përgjegjësi njëherë për shkollën fillore në Reçicë të Vogël, që ngelet premtim gati se 10 vjeçar i pa realizuar i BDI-së. Pastaj të merr përgjegjësi për nepotizmin partiak, për maltretimin e profesorëve, si dhe për arsyen më jonjerëzore që fëmijët shqiptarë të mësojnë në gjuhë maqedonase në Veles, duke mos iu mundësuar



shkollim në gjuhën amë”, thuhet në reagimin e ASH-së në Tetovë.

Fotografinë e ministrit e kemi vendosur tek vendi ku duhet të bëhet shkolla, vijon më tej reagimi, për t’i rikujtuar atij se ai është kompetent edhe për ndërtimin e kësaj shkolle! “Njëkohësisht jemi

të bindur se këto vendime nuk i keni marrë pa u konsultuar me shefin tuaj dhe bëni mirë që të jepni dorëheqje, sepse nuk jeni gjë tjetër veçse marionetë që me vendimet e juaja ju keni sjellë vetëm dëm shqiptarëve!”, thonë në ASH-në e Tetovës. (U.H)

Mbi një muaj zgjasin kontrollet e përforuara të autoriteteve të Kosovës nën dyshimin se bëhet fjalë për riekспорт të miellit nga Serbia, përmes Maqedonisë në Kosovë. Mullisët në Maqedoni ankohen se kanë dëme të mëdha nga pritja e kamionëve në kufi

RRUGA E DYSHIMTË E MALLRAVE SERBE

A PO BËHET MAQEDONIA TRAMPOLINË E SERBISË?



Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 21 shkurt - Mbi një muaj zgjasin kontrollet e përforuara të autoriteteve të Kosovës nën dyshimin se bëhet fjalë për ri eksport të miellit apo eksport nga Serbia përmes Maqedonisë në Kosovë. Mullisët në Maqedoni ankohen se kanë dëme të mëdha nga pritja e kamionëve në kufi.

Sipas kryetarit të Grupacionit të mullisëve në Maqedoni, Goran Malishiq, qëndrimi tetë ditë në kufi ka koston prej një mijë euro, ndërsa për çdo ditë qëndrimi në terminal paguhet edhe 40 euro, ndërsa në fund kostoja është 1200 euro për një transport. Kjo e bën miellin nga Maqedonia jo konkurrues në tregun e Kosovës. Sipas tij, mullisët nuk janë kundër kontrolleve, por kontestojnë mbajtjen me ditë të tëra të kamionëve në kufi.

"Asnjë mulli që eksporton nga Maqedonia në Kosovë nuk kryen reeksport, këtë nuk e lejojnë as ligjet, ndërsa dikush mund të përgjigjet edhe penalisht edhe të dënohet me të holla nëse vepron në këtë mënyrë", shton ai.

MIELLI NGA MAQEDONIA, KU EKA BURIMIN?

Nga Ministria e Ekonomisë, thonë se punojnë në zgjidhjen e problemit. "Unë kisha takim me prodhuesit e miellit në vend lidhur me këtë problem, dhe menjëherë kam kontaktuar homologun tim kosovar. Ai më bindi se për një kohë të shkurtër do të gjendet zgjidhje për këtë çështje", thotë ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi.

Në ndërkohë, autoritetet kosovare kanë shtuar kontrollet pas rritjes së eksportit të miellit nga Maqedonia në Kosovë, prej muajit tetor të vitit të kaluar e këndej. Në vitin 2018, në Kosovë nga Maqedonia janë importuar 2417 tonë miell, ndërsa gati tërë sasia është eksportuar në dy muajt e vitit të kaluar. Njëherazi vetëm në 10 muajt e parë të vitit 2018, nga Maqedonia në Kosovë janë eksportuar vetëm 38.6 tonë miell, ndërsa në tërë vitin 2017 në drejtim të Kosovës janë eksportuar afër 50 tonë miell nga Maqedonia, tregojnë të dhënat e Ministrisë së Ekonomisë së Maqedonisë.

Nga ana tjetër, më 20 shkurt mbushen plot tre muajt që Qeveria e Kosovës vendosi taksën prej 100 për qind për mallrat serbe dhe

boshnjake. Deri te ky vendim erdhi pasi Ministria e Tregtisë dhe Industrisë të Kosovës, ka bërë propozimin e taksës 100 për qind, të cilën e ka përkrahur kryeministri kosovar, Ramush Haradinaj që ka thënë se marrëveshja e CEFTA-s nuk ka funksionuar mes Kosovës dhe Serbisë. "Që një kohë të gjatë Kosova është penguar si në transport si në analiza e në çdo instrument tjetër e CEFTA nuk ka funksionuar mes Kosovës dhe Serbisë. Duke qenë kështu unë e përkrah këtë propozim", ka thënë Haradinaj.

Që nga 21 nëntori i vitit 2018 e deri më datën 20 shkurt, sipas Doganës së Kosovës në vend nga këto dy shtete janë importuar rreth 770 mijë euro mallra, që kryesisht kanë qenë lëndë të parë për të cilat janë paguar edhe masa mbrojtëse. Mirëpo, pavarësisht vendosjes së taksës në Kosovë mallrat e Serbisë vazhdojnë të jenë prezentë.

Gjatë ditës së martë, ministri i Tregtisë, Turizmit dhe Telekomunikimit në Qeverinë e Serbisë, Rasim Lajiq, ka deklaruar se mallrat nga Serbia mund të hasen në gjithë Kosovën dhe se ato po arrijnë përmes rrugëve alternative. Lajiq ka thënë për Radio Televizionin e Serbisë, se nëse shikohet në veri apo në jug të Kosovës, gjithkund mund të hasen mallrat nga Serbia të cilat mbërrijnë atje përmes rrugëve të ndryshme.

"Ka raste kur gruri ynë shkon në Kroaci, prej atje paktohet dhe transportohet në Kosovë si mall i Kroacisë", është shprehur Lajiq. Ai ka përmendur se si pasojë e taksës për tre muajt, Serbia ka humbur 90 milionë euro.

Lajiq ka potencuar po ashtu se humbjet për ekonominë e Serbisë do të jenë edhe më të mëdha nëse bizneset e atjeshme e humbin tregun në Kosovë, ngaqë tashmë, sipas tij janë lajmëruar biznese nga Shqipëria, Sllovenia, Kroacia, Hungaria e tjerë, që duan të përfshihen në këtë treg.

SHQIPËRIA KA BLOKUAR MIELLIN NGA KOSOVA

Në ndërkohë, në maj të vitit të kaluar S hqipëria bllokoi 35 tonë miell nga Kosova, duke dyshuar në nivelin e proteinave. Dyshimet ishin se mielli i importuar nga Kosova ka sasi më të ulët të proteinave sesa masa e lejuar. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në Shqipëri bllokoi 35 tonë miell të kompanive kosovare, pasi që dyshohet se malli me nivel proteine më të ulët blihet me çmim më të lirë në Kosovë dhe shitet në Shqipëri me çmim më të lartë, ku përdoret për prodhimin e bukës. Por kjo po kundërshtohet nga institucionet në Kosovë.

Nga Shoqata e Mullisëve të Kosovës thonë se këtë po e bëjnë kompanitë në Shqipëri me qëllim që të mos kenë konkurrencë në tregun e tyre nga Kosova.

Muhamet Farizi tha se kanë bërë analiza dhe niveli i proteinave është i njëjtë si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri. Por në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës thonë se Kosova nuk e ka një rregullore që përcakton limitin e proteinave në miell. Ish-ministri i bujqësisë së Shqipërisë, Edmond Panariti pranoi se standardi ushqimor i bukës së prodhuar në Shqipëri, për shkak të cilësisë së miellit, është më i ulët në Evropë. Ai kujton se pesë vjet më parë, kur ishte në detyrë, firmosi një udhëzim sipas të cilit mielli që do të përdorej për të prodhuar bukën, duhet të kishte një nivel prej 12.5 proteinash, i cili gjithashtu është ende larg standardit evropian që e kërkon këtë nivel në shkallën 14 për qind. "Miell apo krunde", ne ishim të vendosur që shqiptarët të merrnin cilësinë më të mirë të bukës së tyre", tha Panariti, që shpjegoi se këtij udhëzimi, ju gjetën të çara për ta shmangur. "U kërkua që të importohet dhe miell me nivel 9 për qind proteinash, nga i cili prodhohen biskota apo makarona. Dhe kjo dritare e lënë, u bë një derë ku depërtoi mielli i papër-

shtatshëm. Shteti nuk i kishte dhe nuk i ka kapacitetet të kontrollojë të gjithë zinxhirin e importit të miellit", tha Panariti, sipas të cilit, me sasinë e miellit që importohet gjoja për të bërë biskota, Shqipëria, por dhe gjithë rajoni do të ushqeheshin me këtë produkt.

Në muajin mars të vitit të kaluar, mullisët e Maqedonisë, importues dhe fermerë ishin habitur nga reagimet e Serbisë për eksportin e miellit. Ata vlerësonin se fqinji verior nuk është informuar në mënyrë të drejtë sepse me Rregulloren gjoja të re Maqedonia nuk vendos kurrfarë barriera, as nuk i ndalon dikujt të eksportojë sa të dojë. Vetëm e ndërroi orarin e procedurave plotësisht të njëjta, kohë më parë të definuara, dhe deri tani kushte të vlefshme për import.

Në vend se të vendosen pulla të kontrollit për ta shënuar miellin që në Serbi (ose cilindo shtet tjetër) nga ana e eksportuesve, para se ajo të arrijë në kufirin e Maqedonisë, tani pullat do të vendosen pas kontrollit të tërësishëm të përfunduar të miellit për kujdes shëndetësor, siguri dhe kualitet, apo prejse do të merren rezultatet e analizave të mostrave të marra nga mielli gjatë arritjes së tij në kufi. Më vonë me marrëveshje reciproke u zgjidh edhe ky problem.

Në 15 shtator të vitit 2013, dhe pas shtatë ditësh bllokada u rihapën kufijtë mes Maqedonisë dhe Kosovës. Në mesnatën mes 14 dhe 15 shtatorit hynë në fuqi vendimet e qeverive të dy shteteve për tërheqjen e ndalesave të importit dhe taksës për qytetarët dhe automjetet kosovare. Pas një jave, Maqedonia i dha fund ndalimit të importeve të grurit dhe të miellit nga Kosova, që ishte në zanafillën e një bllokade ndërmjet dy vendeve. Paraprakisht ndalimi i importeve të grurit dhe miellit, bëri që autoritetet në Prishtinë të ndalojnë importet nga Maqedonia të disa mallrave, kryesisht ushqimore.

Tevdovski thotë se po realizohen reformat ekonomike

Shkup, 21 shkurt - Ministria e Financave do të vazhdojë ta përforcojë menaxhimin me financat publike, ta përmirësojë disiplinën fiskale dhe transparencën në shpenzimin e parave publike, theksoi ministri i Financave, Dragan Tevdovski në takim me misionin e Komisionit evropian për vlerësim të Programit për reforma ekonomike (PRE) për periudhën 2019-2021. Delegacionin e KE-së, kumtoi Ministria e Financave, e përbëjnë përfaqësues të drejtorive për zgjerim, për ekonomi dhe financa dhe për punësim. "Programi për reforma ekonomike që u miratua nga ana e Qeverisë më 22 janar të këtij viti paraqet bazë për proceset kyçe reformuese që plotësisht do ta intensifikojnë dialogun tonë me BE-në. Ky është një nga dokumentet themelore për përcaktimin e prioritetëve strategjike të këtij viti të Qeverisë", theksoi ministri Tevdovski. Ai, gjithashtu theksoi se procesi që po zhvillohet nga ana e KE-së është mjaft i rëndësishëm për menaxhimin ekonomik të vendit. Si rezultat i aktiviteteve të ndërmarra deri më tani u realizuan shumica nga rekomandimet që ishin dakorduar në Dialogun e përbashkët ministror në maj të vitit të kaluar, shtoi ai. Përgatitja e PRE-së është koordinuar nga ana e Ministrisë së Financave, ndërkaq i parashtruhet KE-së pas miratimit të tij, më së voni deri më 31 janar. Në takim u bë fjalë për realizimin e konkludimeve dhe rekomandimeve të përbashkëta të miratuara në Dialogun e përbashkët ministror që u mbajt në Bruksel më 25 maj të vitit të kaluar, ndërkaq u shqyrtuan edhe prioritetet për periudhën në vijim në funksion të formulimit të rekomandimeve të mundshme të reja për politikën makro dhe fiskale dhe për reformat strukturore në shtet. Programi për reforma ekonomike 2019-2021 përveç korvizës afatmesme makroekonomike dhe fiskale, parashihet edhe set prej 18 reformave kyçe strukturore sektoriale për rritje të konkurrencës dhe rritjes së ekonomisë. Masat kanë të bëjnë me tregun e energjisë dhe transportin, sektorin bujqësor, industrinë, ambientin afarist dhe uljen e ekonomisë joformale, përmirësimin e infrastrukturës dhe qasjen drejt financave për hulumtim, zhvillim dhe inovacione, lehtësimin e tregtisë, punësimin dhe tregun e punës, si dhe mbrojtjen sociale dhe inkluzionin.

LIGJI I RI PËR KONTROLL INSPEKTUES

PËR 30 PËR QIND DO TË RRITEJN PAGAT E INSPEKTORËVE

“Shifra e tanishme prej 1000 inspektorëve është absolutisht e pamjaftueshme që të arrihet gjithçka. Me rregullat e tanishme që nuk përgjigjen me realitetin askush nuk do të mund të bëhet inspektor në disa vite të ardhshme. Tani e hapim mundësinë dhe çdo shërbim inspektues, sipas mundësive të tyre, do të duhet të bëjë punësime”, thotë ministri



natës ku ka persona të alkoolizuar, shpesh herë edhe janë sulmuar. Nuk është e njëjtë të jesh inspektor i tregut dhe inspektor në arsim”, tha dje në konferencën për shtyp ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Damjan Mančevski. Analizat e të gjitha shërbimeve inspektuese kanë treguar mungesë të kuadrove në nivel lokal dhe shtetëror. Që të mundësohen punësime të reja, vendoset edhe sistem i ri për marrje të licencave për inspektor dhe për trajnimin e tyre të përhershëm dhe përkryerjes profesionale.

“Shifra e tanishme prej 1000 inspektorëve është absolutisht e pamjaftueshme që të arrihet gjithçka. Me rregullat e tanishme që nuk përgjigjen me realitetin askush nuk do të mund të bëhet inspektor në disa vite të ardhshme. Tani e hapim mundësinë dhe çdo shërbim inspektues, sipas mundësive të tyre, do të duhet të

bëjë punësime”, thotë ministri. Ai konsideron se Ligji i ri do të krijojë klimë të volitshme të punës për inspektorët dhe subjektet në kontroll. Ndikim më i madh pozitiv pritet për ndërmarrjet e vogla, të cilat, përkujtoi Mančevski shpeshherë duhet të mbyllin për shkak të parregullsisë të konfirmuara gjatë kontrollit inspektues, pa u dhënë shans t’i mënjanojnë. Vendoset edhe koncept i ri i kontrollit inspektues përmes planifikimit të inspektorateve në bazë të vlerësimit të rrezikut. Inspektoratet, ka potencuar ministri resor, nuk do të munden më të shfrytëzohen si mekanizëm për presionin politik ose ekonomik. Si rregull vendoset vërejtja para caktimit të dënimit.

“Kontrolli inspektues duhet të ndalet të jetë mekanizëm për mbushjen e buxhetit. Kontrolli inspektues duhet së pari ta ketë rolin këshillëdhënës. Subjektet së pari do të marrin vërejtje dhe afat ta

mënjanojnë parregullsinë, para se të caktohet dënimi. Vetëm në mënyrë të tillë inspektorati nuk do të perceptohet si represion”, sqaroi Mančevski duke potencuar se përjashtim i kësaj do të jenë rastet kur inspektor do të vlerësojë se parregullsitë e konfirmuara mund të shkaktojnë rrezik për jetë dhe shëndetin e qytetarëve”, dëm financiar, rrezikim të mjedisit jetësor ose rrezikim të interesit publik. Zgjidhja e re ligjore duhet të sigurojë edhe parashikueshmëri të kontrollit inspektues përmes listës për kontroll. Çdo subjekt i cili është lëndë e kontrollit inspektues, para vizitës së inspektorëve, do të marrë listë të dokumenteve konkrete dhe informatave të cilat duhet t’i sigurojë. Me atë gjatë takimit me inspektorët, subjektet do të jenë të gatshëm dhe kontrolli inspektues do të zgjasë më pak. Miratimit të ligjit i kanë paraprirë shumë debate publike.

Koha

Qefser ABDYLI

Shkup, 21 shkurt - Pagat e inspektorëve do të rriten për 10 për qind në fillim të vitit të ardhshëm dhe do të arrijnë rritje për 30 për qind në vitin 2022. Kapaciteti i shërbimeve inspektuese të përforcohet me kuadër të re, ndërsa gjatë sanksionimit të vendoset rregull për vërejtje para caktimit të dënimit, parashikon Ligji i ri për kontroll inspektues, i miratuar në seancën e fundit qeveritare.

“Me ligjin parashikohet dinamika për rritje të pagave, por përparësi do të kenë shërbimet inspektuese të ekspozuar në rrezik më të madh, për shembull si Inspekcioni i tregut. Ata punojnë edhe në mbrëmje në klubet e

“INKLUZIVA” ME AKUZA TË REJA

Qytetarët me aftësi të kufizuara të përjashtuar nga jeta politike

Shkup, 21 shkurt - Legjislacioni zgjedhor nuk harmonizohet me dispozitat e Konventës së KB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, ekzistojnë dispozita diskriminuese me të cilat këtyre personave u merret e drejta e përzgjedhjes, gjegjësisht një grupi të caktuar të qytetarëve me aftësi të kufizuara sipas procedurës gjyqësore u merren aftësia afariste dhe sipas kësaj baze këta persona fshihen nga lista zgjedhore sikur nuk ekzistojnë. Personave me aftësi të kufizuara të cilët gjenden në fa-

milje kujdestare nuk u mundësohet të votojnë në vendin ku janë nën përkujdesje. Në Kodin zgjedhor këta persona janë të evidentuar dhe i realizojnë të drejtat së bashku me personat e sëmurë dhe të pafuqishëm, u tha në konferencën për shtyp në Komisionin Shtetëror Zgjedhor, të organizuar nga Shoqata për promovim dhe zhvillim të shoqërisë inkluzive “Inkluziva”. Shoqata “Inkluziva” në procesin e referendimit në vitin 2018 me 40 vëzhguesit e saj e aftësi të kufizuara për herë të parë u bë organi-

zatë e akredituar për vëzhgim. Bllagica Dimitrovska, kryetare e Shoqatës “Inkluziva” tha se shteti ynë është një shtet demokratik, por përjashtimi i një grupi qytetarësh nga jeta politike tregon në faktin se nuk janë krijuar kushte për respektimin e parimit më të rëndësishëm në sistemin demokratik - e drejta e përzgjedhjes dhe se e drejta e përzgjedhjes është e drejtë e garantuar pa marrë parasysh përçarë aftësi të kufizuara bëhet fjalë.

Oliver derkovski, kryetar i KSHZ-së theksoi se anëtarësimi në

këshillin zgjedhor nuk sjell deri në përmirësim të punës së këshillit zgjedhor sepse, siç tha, është treguar se vëzhguesit asgjë nuk mësojnë nga trajnimet. Në pyetjen nëse ka të punësuar persona me aftësi të kufizuara në KSHZ, Derkovski deklaroi se në institucionin e tyre edhe ashtu kanë numër të madh të të punësuarve nga numri i nevojshëm, megjithatë ky është proces dhe se si çdo administratë publike kërkojnë harmonizim nga Ministria e Financave për punësim. (D.K)

KLUBI I MJEKËVE TË RINJ

Kujdes më i madh për praktikën e mjekëve të rinj

Shkup, 21 shkurt - Klubi i mjekëve të rinj kumtoi se rëndësi të posaçme ka që projekti të cilin e ka paralajmëruar Ministria e Shëndetësisë të ketë sukses, sa i përket asaj që menjëherë pas diplomimit, gjegjësisht marrjes së licencës, ato të fitojnë mundësinë për punë praktike gjatë muajve në shtëpitë e shëndetit, për të cilët do të sigurohen vende pune në Ndihmën e shpejtë, pikat e vaksinimit dhe në shërbimin polivalent të patronazhit, ndërsa pastaj të mund të specializojnë. Sipas atyre, bëhet fjalë për projekt që do të shfrytëzojë shumë mjete nga buxheti i shëndetësisë. “Për shkak kësaj, mendojmë se sukcesi ka rëndësi të madhe jo vetëm për ne, por edhe për ardhmërinë e marrëdhënieve me pushtetin qendror. Që projekti të ketë sukses mendojmë se duhet t’i përkushtohet më shumë kohë fazës së përgatitjes dhe analizimit të modelit”, thuhet në Klubin e mjekëve të rinj. Thonë se duhet të kenë kujdes sa do të garantohet punësimi i mjekëve të sapodiplomuar, nëse paraqiten në konkursin e njëjtë edhe mjek më të vjetër nga gjeneratat paraprake, të cilët janë të papunë apo planifikojnë të fillojnë specializim, duke pasur parasysh se ky stazh do të jetë kusht për specializim, ndërsa duhet të përgatitet analizë me nevojat dhe problemet në konsultim me të gjitha palët e përfshira, si dhe institucionet, sektorin civil, shfrytëzuesit e shërbimeve të shëndetit publik dhe të përcaktohen kritere saktë për sistemimin e mjekëve të rinj nëpër shtëpitë e shëndetit në vend. Sipas Klubit të mjekëve të rinj, duhet të hulumtohet mundësia që stazhi i tillë gjatë muajve të mbahet atje ku ka bazë ai të shndërrohet në punësim të përhershëm, që të rinjtë të japin mund më të madh dhe mos e shohin këtë vetëm si praktikë e obliguar, të konsultohen kuadrot akademike në vend për drejtimin në të cilin duhet të fokusohet projekti që të ketë perspektivë dhe të mos shihet vetëm si zbutje e përkohshme e padurimit të mjekëve të rinj, të vlerësohet sa ky kusht shtesë për specializim, do ta shtyjë krijimin e specialiteteve të rinj të cilët janë deficit për shkak largimit të vazhdueshëm të mjekëve të Maqedonisë jashtë vendit. (D.K)

Katër të arrestuar, policia u gjeti marihuanë

Tetovë, 21 shkurt - Pjesëtarët e Policisë së Tetovës të mërkurën rreth orës 14 e 30 minuta, në fshatin Bogovinë të Tetovës kanë ndaluar një veturë të tipit "Opel Corsa" me targa të Gostivarit, të drejtuar nga 22 vjeçari me iniciale A. Xh nga fshati Dobëridoll, kurse në veturë si bashkudhëtarë kanë qenë personat Xh. I (26) dhe O.M (28), të dy nga fshati Gradec. Gjatë kontrollit të kryer ndaj tyre është gjetur marihuanë. Tre personat janë privuar nga liria dhe janë mbajtur në Stacionin policor në Tetovë, deri në zbardhjen e plotë të rastit. Po ashtu, të mërkurën mbrëma rreth orës 21 e 45 minuta, në fshatin Banjicë e Poshtme e Gostivarit, është arrestuar 40 vjeçari R. J. nga Gostivari, tek i cili është gjetur lëndë narkotike marihuanë. Për shkak të dyshimit për prodhim ilegal dhe lëshim në përdorim të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve i njëjti është mbajtur në Stacionin policor Gostivar për procedurë të mëtejshme. (U.H)

Në Shkup, "karrotreci" ka larguar 106 automjete

Shkup, 21 shkurt - Në Shkup gjatë 24 orëve të fundit policia ka sanksionuar 58 shoferë të cilët kanë drejtuar automjetin me shpejtësi mbi të lejuarën, një shofer nën ndikimin e alkoolit dhe 15 shoferë para se ta marrin patentën e shoferit. Sipas buletinit të SPB Shkup gjithsej kanë ndodhur katër aksidente komunikacioni prej të cilave në njërin më lehtë është lënduar një person, ndërsa në tre është shkakuar dëm material. Nga komunikacioni janë përjashtuar gjithë automjete me probleme teknike dhe 13 të paregjistruara. Policia e komunikacionit ka dhënë 151 masa për parkim jo të drejtë, ndërsa me automjetin e posaçëm karrotrec janë larguar 106 automjete. Janë sanksionuar edhe tre këmbësorë të cilët e kanë kaluar rrugën jashtë vendkalimit për këmbësorë, një këmbësorë i cili e ka kaluar rrugën në dritë të kuqe të semaforit, një shofer i cili ka kaluar në udhëkryq në dritë të kuqe, pesë shoferë të cilët nuk u kanë dhënë të drejtë kalimi këmbësorëve në vendkalim të shënuar për këmbësorë, shtatë për reshtim jo të drejtë dhe tre për tejkalim jo të drejtë. Është dënuar edhe një shofer për mosmbajtje të pajisjeve dimërore, 24 për mosmbajtjen e rripit të sigurimit dhe 27 për shfrytëzimin e telefonit celular.

Familja Pajaziti nga Shkupi mund të ngelë në rrugë, për arsye se ata nuk kanë shtëpi dhe pronari i banesës ku aktualisht janë me qera u ka dhënë afat 3 javë t'ia lirojnë. Ata nuk kanë të ardhura të përballojnë këtë situatë dhe lusin njerëzit vullnetmirë t'iu ndihmojnë

Koha Qefsere ABDYLI

Shkup, 21 shkurt - Familja katër anëtarësh e Bashkim Pajazitit nga lagja e Dizhonit të Shkupit, tash e disa vite jeton në kushte tejet të rënda ekonomike-sociale. Nga pamundësia për të punuar kryefamiljari Bashkim Pajaziti, jeta e tyre mori një drejtim krejt tjetër, atë të mjerimit. Pajaziti thotë se më herët ka punuar çdo lloj pune, ndërtimtari apo çdo punë që i është ofruar, mirëpo tani ai ka probleme shëndetësore ku dhe ia pamundëson për të punuar dhe për tu siguruar kafshatën e bukës dy fëmijëve të tij.

"Më herët kam punuar nëpunë të ndryshme, ndërtimtari apo edhe punë të tjera sa për t'ua siguruar gojën e bukës dy fëmijëve të mi të vegjël. Mirëpo tani më është pamundësuar kjo pasi kam probleme me boshtin kurrizor dhe nuk mundem asnjë lloj pune të bëjë.

Banoj me qira gati 9 vite, tash së fundmi në lagjen Dizhon. Ajo që më brengos tani është se pronari i shtëpisë ku jetoj për momentin më ka dhënë afat 3 javor që ta lëshoj shtëpinë, pasi që i

KRONIKË TRONDITËSE E FAMILJES PAJAZITI

JETË E RËNDË PA KULM MBI KOKË



njëjti do ta shesë. Nuk e di ku të shkojë dhe si ti ja bëjë, unë të ardhura nuk kam nga askush, jetoj pa ndihma sociale, qiranë e paguaj 4000 denarë, po edhe këto parat e qirasë janë çka mi japin fqinjët, çdo natë nuk po kam me çka ti ushqejë fëmijët, ka ndodhur që edhe pa ngrënë kemi fjetur", thotë me lot në sy Bashkim Pajaziti.

Ai ka dy fëmijë njërin 9 vjeç dhe tjetrën 6 vjeç, dhe si çdo fëmijë edhe ato kanë ëndrra për

një jetë më të mirë por edhe që të kenë një shtëpi të tyre. Kryefamiljari Pajaziti thotë për gazetën KOHA se nuk ka as edhe një familjar që mund të ia zgjasë dorën dhe për momentin ka mbetur nën mëshirën e fatit, pasi që edhe u kanoset rreziku për të mbetur në rrugë. Kjo familje edhe pse kanë jetuar në këtë shtëpi deri tani kushtet kanë qenë të mjerueshme, sepse vetëm në një dhomë po jetojnë. Apeli i tij është që të del ndonjë

njeri human dhe të ua sigurojë një vend strehim pasi që e ka të vështirë që bashkë me bashkëshorten dhe dy fëmijët të dal në rrugë, nën qiellin e hapur dhe të kalojë kush e di se sa net aty.

Të gjithë të interesuarit që duan të ndihmojnë këtë familje mund të kontaktojnë në numrin e telefonit: +389 70 454 579, ose drejtpërsëdrejti në Lagjen Dizhon, përball shkollës fillorë "Imri Elezi", afër dyqanit Karshiaka.

Punëtori për shfrytëzim më të mirë të fondeve të BE-së

Tetovë, 21 shkurt - Mbi 400 projekte të mbështetura nga Bashkimi Evropian për momentin zbatohen në Maqedoninë e Veriut, informon udhëheqësi i Repartit për bashkëpunim në delegacionin e BE-së në Shkup Nikollo Bertolini në punëtorinë e sotme që u mbajt në Tetovë me përfaqësuesit e komunave, organizatave joqeveritare, bashkë-

sive të biznesit, fermerët dhe qytetarët. Bertolini potencoi se 40 për qind e këtyre projekteve zbatohen në komuna, ndërsa gjashtë për qind janë destinuar për sektorin joqeveritar. "Me këtë mënyrë të sistemit të mjeteve dhe projekteve duam të tregojmë se me inkudrimin e vendit në familjen e madhe të BE-së duam t'i mbështe-

sim të gjithë në tërë shtetin, ndërsa jo vetëm në nivel qendror. Punëtorja e sotme në Tetovë vjen pas dhjetë punëtorive të tilla të mbajtura paraprake në të gjithë shtetin, në të cilat duam më mirë t'i njoftojmë problemet direkt nga të gjithë faktorët në nivel lokal që t'u ndihmojmë më lehtë të marrin mjete nga fondet e BE-së që qen-

drojnë në dispozicion", tha Bertolini. Në lidhje me gjendjet e viteve paraprake, kur një pjesë e madhe e mjeteve të fondeve të BE-së mbesin të pashfrytëzuara, Bertolini tha se ka pasur projekte që nuk janë zbatuar siç duhet, si dhe mosshfrytëzimi i fondeve të caktuara, por që në periudhën e fundit vërehet përmirësim i vogël në atë drejtim.

Të rinjtë kërkojnë kinema në Tetovë

Tetovë, 21 shkurt - Pjesëmarrësit e Klubit të liderëve të rinj, të udhëhequr nga Shoqata Multikultura, organizuan natën e filmit ku përmes projektimit të filmit në një ambient të hapur, përcollën mesazhin se qytetit të tyre i mungon kinemaja. Ideja e këtij aktiviteti lindi gjatë përgatitjes së iniciativave rinore për ngritje të vetëdijes qytetare për fenomene të ndryshme të cilat i

tangojnë ata në. Të rinj nga grupe të ndryshme etnike, dhe nxënës nga të gjitha shkollat e mesme të qytetit të Tetovës u bashkuan për të ngritur zërin për një jetë më të pasur kulturore në qytetin tonë. Behar Shaqiri, koordinatori i kësaj iniciative, thotë se mungesa e një kinemaje në qytetin e Tetovës është një nga fenomenet aktuale për të cilën rinia ka shumë nevojë. "Mungesa e kinemasë do të thotë

shumë për identitetin tonë kulturor. Hapja e një kinemaje në Tetovë, sado e thjeshtë në kushte dhe paraqitje, mbetet për ne një nevojë e kamotshme", u shpreh ai. Shenoll Jakupi, pjesëmarrës i Klubit të liderëve të rinj, u shpreh falënderues ndaj shoqatës Multikultura, e cila i përkrah çdoherë në iniciativat e këtyra. "Multikultura ndihmon në zhvillimin tonë personal dhe profesional. Aty

gjen hapësirë dhe përkrahje çdo ri që ka një ide, e cila kontribuon në zhvillimin pozitiv të komunitetit", theksoi ai. Aktivitetet e projektit "Fuqia e zërit të të rinjve në rajonin e Pollogut" financohen nga Bashkimi Evropian në kuadër të projektit "Ndryshime për qendrueshmëri", i cili implementohet nga Shoqata Konekt, Fondacioni Apollonia dhe Qendra për politika tatimore. (U.H)

21 shkurti, shqipja në Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës

Nga
Rami MEMUSHAJ

21 shkurti është Dita Ndërkombëtare e Gjuhës Amtare, që kremtohet në të gjitha vendet e botës. Qëllimi i caktimit nga UNESCO-ja të kësaj dite si dita e gjuhës amtare ka qenë vlerësimi i gjuhës si mjeti më i rëndësishëm për ruajtjen dhe trashëgimin e kulturës së çdo populli dhe i nevojës për të nxitur lëvrimin e gjuhëve amtare të popujve dhe të etnive dhe të popujve të botës, të cilat janë pjesë e thesarit kulturor të njerëzimit.

Duke u ndalur këtë ditë te gjuha shqipe, si gjuha amtare e shqiptarëve kudo ku ata jetojnë, vërejmë me kënaqësi se statusi i saj këta 100 vjetët e fundit ka ardhur duke u rritur. Nga gjuhë e ndaluar nën pushtimin otoman, me shpalljen e Pavarësisë më 28 Nëntor 1912, ajo u bë gjuhë zyrtare e shtetit shqiptar, ndonëse mbeti gjuhë e ndaluar për pjesën tjetër të kombit që u bënë me dhunë pjesë e shtetit grek dhe e Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene. Kjo gjendje u përmirësua pas Luftës së Dytë Botërore, kur shqiptarët e Kosovës, të Maqedonisë dhe të Malit të Zi fituan të drejtën e shkollimit në gjuhën amtare dhe hapën shkolla të të gjitha niveleve deri te Universiteti i Prishtinës dhe katedra e gjuhës shqipe në Universitetin e Shkupit. Me kushtetutën jugosllave të vitit 1974, shqipja në këto troje u ngjiti në shkallën e gjuhës zyrtare rajonale në Kosovë dhe të gjuhës zyrtare paralele në Maqedoni. Këtë fillim shekulli, me shpalljen e Kosovës shtet i pavarur, shqipja u bë gjuhë zyrtare kryesore, ndërsa në Maqedoni që nga vitet '80 të shekullit të kaluar e deri një vit më parë, shqipja ra në statusin e gjuhës rajonale të papërkrahur nga shteti. Po vitin e kaluar, me miratimin nga parlamenti maqedonas i ligjit për gjuhën shqipe, kjo u njoh si gjuhë zyrtare rajonale, pra fitoi status zyrtar, po jo me të njëjtin status me maqedonishten, sikundër ia kishte njohur kushtetuta jugosllave. Përtej këtyre trevave, në Mal të Zi shqipja ruan statusin që ka pasur, si gjuhë rajonale e përkrahur nga shteti; në Greqi për popullsinë e trevave shqiptare brenda kufijve të këtij shteti dhe për arbërorët shqipja është gjuhë e papërkrahur nga shteti, por jo e ndaluar të mësohet nga fëmijët e emigrantëve; në Itali shqipja është gjuhë e përkrahur e pakicës arbëreshe dhe e lejuar të mësohet nga fëmijët e emigrantëve shqiptarë, ashtu si në gjithë Europën; kurse në



Turqi shqipja nuk mësohet nga fëmijët e emigrantëve.

Gjuha shqipe ka përparuar shumë këta njëqind vjet edhe për sa i përket shkallës së përpunimit të saj. Nga gjuhë me disa variante letrare e dy gjuhë zyrtare (toskërishtja në Shqipëri, gegërishtja në trojet shqiptare në ish-Jugosllavi), prej vitit 1972 ajo është ngritur në shkallën e gjuhës letrare kombëtare, të pranuar nga të gjitha pjesët e kombit. Ishte

Konsulta e Prishtinës eprillit 1968 ajo që hodhi hapin e madh të bashkimit gjuhësor, kur intelektualët shqiptarë të atjeshëm, të udhëhequr nga motoja "një komb – një gjuhë letrare", shpallën se shqiptarët në Jugosllavi pranonin "si gjuhë të vetën letrare gjuhën letrare të vendit ëmë". Kongresi i Drejtshkrimit e sanksionoi këtë vendim të tyrin, duke shënuar në këtë mënyrë fundin e periudhës kur shqipja shkruhej në disa varian-

Si pasojë e mungesës së kujdesit shtetëror për gjuhën, në botimet, në gazetat e revistat, në televizionet dhe në dokumentacionin zyrtar vërehen shkelje të pafalshme të normave të gjuhës letrare. Më e dukshme kjo dukuri e shëmtuar është në fushën e fjalorit, ku vërehet një vërshim i fjalëve të huaja të panevojshme



te dhe fillimin e jetës kombëtare shqipes letrare. Periudha nga Kongresi i Drejtshkrimit e deri më 1990 vlerësohet nga të gjithë si periudha e përpjekjeve për zotërimin dhe përdorimin e normave të gjuhës letrare në të gjithë veprimtarinë ligjëruese të shkruar e të folur. Në trojet shqiptare të ish-Jugosllavisë Konsulta u vuri detyrë shkollës enteve botuese, redaksive e gazetave dhe administratës zbatimin e normën letrare; kurse në Shqipëri, zbatimi i normave të gjuhës letrare nga shkolla, entet botuese dhe administrata shtetërore u bë i detyrueshëm me një vendim të vitit 1978 të Këshillit të Ministrave.

Pas viteve '90, me përmbysjen e sistemeve politike njëpartiake dhe kalimin në pluralizëm, u vu re një rënie e theksuar e kujdesit për gjuhën nga të gjithë, nga shteti e shoqëria, që u pasua edhe me kontestime të gjuhës letrare e me përpjekje për krijimin e gjuhëve të reja letrare. Në praktikën e ligjërimit të shkruar e të folur, për fat të keq, kjo gjendje vijon edhe në ditët tona, kur vijon mungesa e pafalshme e kujdesit të shtetit për gjuhën, ndonëse kushtetutat e të dy shteteve shqiptare e shpallin mbrojtjen e gjuhës si detyrim shtetëror. Sa pak e mbrojmë gjuhën

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goe Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovaja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Sloboden Pecat" - rr. Kej 13 Noemvri nr.3/1-238, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e enjës, 21 shkurt 2019 | Numri i parë i gazetës do të më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup


NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

shqipe, kjo duket po ta krahasojmë gjendjen në këtë pikë me vendet fqinje. Maqedonia e Veriut ka një ligj për gjuhën i cili parashikon sanksione të rrepta për shkelësit e tij – institucione, redaksi apo ente botuese. Kurse as Shqipëria dhe as Kosova nuk kanë ende një ligj për gjuhën, ndonëse projektligji përkatës është depozituar prej kohësh në të dy kuvendet.

Si pasojë e mungesës së kujdesit shtetëror për gjuhën, në botimet, në gazetat e revistat, në televizionet dhe në dokumentacionin zyrtar vërehen shkelje të pafalshme të normave të gjuhës letrare. Më e dukshme kjo dukuri e shëmtuar është në fushën e fjalorit, ku vërehet një vërshim i fjalëve të huaja të panevojshme, madje i fjalëve "kopile", si realizoj, akses e aksesoj, tentoj, mesazh etj., të cilat po e drunjëzojnë po e venitin gjuhën, duke u zënë vendin dhjetëra fjalëve të bukura shqipe që përdoren në kontekste të ndryshme sintaksore; edhe në fushën e drejtshkrimimospërdorimi i shkronjave dhe është tregues i injorancës kompjuterike, po edhe mungesë e respektit për alfabetin tonë, për shkronjat e të cilit është derdhur gjak. Në televizione po sundojnë modele akcentologjike të huaja, duke i theksuar fjalët e thjeshta e kompozitat në rrokjen e parë si në anglishte, kur modeli theksor i shqipes kërkon theksimin fundor të fjalës, veçanërisht të fjalëve të përbëra, në të cilat pa asnjë përjashtim theksohet përbërësi i dytë. Ky model i huaj theksimi ka prishur edhe melodinë dhe metrikën e frazës, që nuk tingëlton më si shqip, po si një surrogat shqip-anglisht-italisht.

Sot, në Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare, është rasti t'u drejtohem shkollës, shtypit dhe të gjithë atyre që janë përfshirë në ligjërimin publik, me thirrjen që të tregojnë respekt për gjuhën tonë, e cila është tipari i vetëm që na dallon prej të tjerëve dhe na bashkon ne shqiptarët në një komb. Thirrja jonë i drejtohet edhe shtetit që të kujdeset për gjuhën, në radhë të parë, duke miratuar ligjin përkatës, i cili do t'u jepte zgjidhje shumë problemeve, duke krijuar një mjedis të pastër nga ndotjet gjuhësore e shkeljet e normave të gjuhës letrare. Dhe deri në miratimin e këtij ligji jemi të mendimit që shteti të kthejë në fuqi vendimin e Këshillit të Ministrave të vitit 1978.

Bizneset me pasaporta të BE forcojnë populistët



Nga
Ivalyo DITCHEV

Bashkimi Europian ndjek shembullin e Perandorisë Romake, që u jepte të huajve nënshtetësinë, për të rritur ndikimin mbi popujt fqinjë. Premtimi për zgjerimin e BE i ka stabilizuar dhe qetësuar për shumë vite fqinjët. Koncepti i një shtetësie pan-evropiane, e parashikuar me Traktatin e Mastrihtit, mund të ketë shkaktuar qëkur tek disa evropianë një farë pakënaqësie. Shoku i madh erdhi pastaj me zgjerimin e BE në lindje: Në vitin 2007 anëtarët e rinj, Bullgaria dhe Rumania, pavarësisht nga tingujt ritualë të himnit të BE, "Odës së Gëzimit" të simfonisë së nëntë të Beethovenit, u pritën pa kurrfarë gëzimi. Pyetja se ku duhet të shtriheshin kufijtë e jashtëm të BE, hynte gjithnjë e më shumë në qendër të debatit publik. Një nga manipulimet më të suksesshme të fushatës "Leave", para referendimit për Brexitin në vitin 2016, ishin pohimet e qëllimshme, se me zgjerimin e ardhshëm të BE rreth 70 milionë turq do ta "mësynin" Britaninë e Madhe.

PËRVETËSIMI NACIONALIST I PAKICAVE ETNIKE

Problemet e mëdha lindin edhe nga përvetësimi nacionalist i pakicave etnike, që jetojnë në vende të tjera. Koncepti i Hitlerit për "gjeranët etnikë", të cilin ai e përdori si pretext për ndërhyrjet ushtarake në shtetet sovraane, është hedhur poshtë në mënyrë të qartë. Por në praktikë "gjaku" dhe prejardhja në shumë raste duket se vazhdojnë të gëzojnë një status të posaçëm ligjor. Pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, Gjermania apo Greqia u dhanë shtetësinë pjesëtarëve të pakicave të tyre, të cilët u kthyen nga vendet e tjera në atdheun e të parëve. Hungaria dhe më vonë Bullgaria e aplikuan parimin e "etnisë" në një mënyrë edhe më nacionaliste, sepse sipas ideologjive të tyre kombëtare ato kufizohen me territoret e "veta", që u janë shkëputur me luftëra të padrejta. Që nga viti 1993 dhënia e shtetësisë hungareze pjesëtarëve të pakicës hungareze në vendet fqinje - në bazë të origjinës - është një sinjal politik. Kritika e liberalëve të majtë në Hungari ndaj kësaj praktike nuk ka sjellë asnjë rezultat.

Në rastin e Bullgarisë shpesh nuk ekzistojnë dokumente për origjinën (diçka jo e pazakontë për Ballkanin), kështu që për anëtarët e pakicave jashtë vendit vlen "vetëdija e tyre bullgare". Teorikisht çdo

qytetar nga Maqedonia e Veriut mund të pretendojë se është bullgar, sepse sipas doktrinës së nacionalistëve bullgarë maqedonasit i përkasin "kombit bullgar". Nëse marrin pasaportën bullgare, qytetarët e rinj bullgarë mund të udhëtojnë në drejtim të veriut dhe perëndimit, ku mund të jetojnë e të punojnë pa viza edhe në shtete të tjera të BE.

BIZNESI I NDYRË ME PASAPORTA BULLGARE

Nuk ka kritere të qarta për të përcaktuar se çfarë është "vetëdija bullgare" dhe puna hermeneutike mbetet në duart e disa zyrtarëve të caktuar. Kështu lulëzoi një biznes i ndyrë, në të cilin pasaportat bullgare shiteshin për 5000 euro, derisa ai u zbulua në vitin 2018. Në këto afera të korruptuara ishin përfshirë edhe anëtarët e një partie nacionaliste nga Bullgaria, të cilët ishin në garë, se kush ia kalonte njëri-tjetrit memetaforat nacionaliste.

Shtetësitë përdoren në të njëjtën kohë edhe si burime ekonomike: në rastin e të ashtuquajturave "golden visa" dhe programeve të investimeve. Në këtë kontekst Komisioni Evropian krahas Bullgarisë ka kritikuar edhe Qipron dhe Maltën. Jo duke vënë në diskutim parimin në vetvete, por duke kritikuar vetëm faktin se nuk ka mekanizma të mjaftueshëm kontrolli. Kështu ekziston rreziku, që kriminelët të arrijnë të marrin këto shtetësi. Komisionerja e BE për Drejtësinë, Vera Jourova, përmendi për shembull qytetarë të dyshimtë rusë, të cilët përmes këtyre vendeve mund të hynin në BE.

Problem nuk është vetëm siguria. Pas fasadës ligjore ka një treg të vërtetë, ku shiten shtetësi në një konkurrencë të ashpër midis

Shtetësia blihet me para në dorë - kjo është e mundur në disa vende të BE. Një zhvillim i rrezikshëm, që nxit parimet rudimentare të vendosjes së barrierave ndaj të huajës, si racës dhe fesë



qeverive. Vendet më të vogla ofrojnë mundësinë e marrjes së shtetësisë përmes investimeve "modeste". Sapo investitori fiton pasaportën e dëshiruar, ai mund ta anulojë investimin, duke e shitur përsëri atë që bleu. Shtete të tjera premtojnë se nuk janë të nevojshme testet gjuhësore apokontrollet mjekësore. Me një shumë të caktuar parash, ose me donacione të detyruara, mund të arrihet shpejt direkt te shtetësia. Oferta më e përsosur: Nuk është aspak e nevojshme prania fizike në vendin, shtetësinë e të cilit synon të marrësh. Kështu investitori i ardhshëm mund të bëhet nga plazhi shtetas i një vendi të BE, pa qenë nevoja të largohet nga parajsja taimore, në të cilën ai apo ajo jeton.

SHTETET PERIFERIKE PRAKTIKOJNË DUMPINGUN E SHTETËSIVE

Nuk është çudi që një cinizëm i tillë të kthehet në bumerang. Pa-

rimi bazë i përkatësisë kombëtare kompromentohet. E zhveshur nga të gjitha detyrimet morale, kombësia e një vendi degradohet në një instrument, me anë të të cilit synohen të arrihen vetëm qëllime politike, ideologjike apo ekonomike. Efekti është i rrezikshëm, sepse për të krijuar ndjenjën e përkatësisë, ofrohen parime rudimentare si raca, feja ose fantazitë historike. Edhe kjo e minon BE. Shtetet periferike praktikojnë një dumping të shtetësisë, në mënyrë të ngjashme si në tregun e punës apo në sferën sociale. Po si nuk është bërë akoma problem? Gjigantët industrialë si Gjermania duket se e tolerojnë për momentin, sepse kjo është për ata një rrugë e fshehtë për të siguruar fuqinë punëtore aq shumë të nevojshme, pa u përballur me nacional-populistët në vendin e tyre. Por druhem se pakënaqësia ka për t'u shtuar, në një mënyrë të rrezikshme.

Ka dy rrugëdalje. Ne mund të implementojmë ligje të përbashkëta për dhënien e shtetësisë, që të jenë të detyrueshme për të gjitha vendet e BE: procedura të njëjta, kushte të barabarta, të drejta të barabarta. Por kjo do të ishte shumë e vështirë në kohën e populizmit. Një mënyrë më e thjeshtë do të ishte diferencimi ndërmjet nivelit të BE dhe atij kombëtar: fillimisht të bëhesh maltez, bullgar etj., pastaj të aplikosh për një shtetësi evropiane mbikombëtare. Kush mendon se kjo është kundër traktateve evropiane, duhet të marrë një gjë në konsideratë: nëse praktika mashtruese e dhënies së shtetësisë nuk ndalet, do të krijohet një lloj hierarkie e pasaportave të BE-së, pavarësisht nëse na pëlqen apo jo. (DW)





SILVANA RUSI FEMRA DUHET TË JETË E FORTË, TË MOS I DRIDHET QERPIKU PËR ASGJË!

Sapo ka publikuar një klip me një titull interesant dhe të çantë "Kriminale" një klip që ka gjetur vendin e tij mes dashurisë së publikut. Silvana Rusi është autorja e kësaj kënge dhe klipi e duke qenë se Silvana vjen nga konkurse muzikore si "Gjeniu i vogël" apo "X factor" e ka qenë pjesëmarrëse në festivale të ndryshme, nuk mund të prisnim diçka më pak origjinale dhe të realizuar e këto duke i treguar në një bisedë për InfraRed të gazetës KOHA

Koha Bisedoi: Blerand REXHEPI

KOHA: Silvana, në klipin e fundit "Kriminale", vjen ndryshe nga herët e tjera, më hot, më agresive, më e fortë gjë që shihet jo vetëm në veshje, por edhe në interpretim. Po mesazhi që përcjell kënga, cili është?

Kriminale projekti i ri ishte një ide që erdhi shumë spontanisht, sa i përket mesazhit të këngës gjë që patjetër ka lidhje me fabulën e klipit që çdo femër duhet të jetë tepër e fortë dhe pa ju dridhur qerpiku nga dhimbja pas një ndarje që mund të ketë ndodhur për faje jo të tuat, kuptohet. Sigurisht nuk zgjidhet me armë, por po flasim për forcën e shpirtit.

KOHA: Në këtë klip të pamë jo vetëm si këngëtare, por edhe si aktore, sepse interpreton shumë bukur. Të ka ndihmuar dikush apo aktrimi është një tjetër pasion që nuk e ke shfaqur deri më sot?

Në fakt, aty çdo gjë më ka ardhur natyrshëm, por pa frikë e them se e dashuroj aktrimin.

KOHA: Kush u kujdes deri në detaj që klipi të realizohej sa më mirë?

Për këtë realizim do falënderoj shumë motrën time Beauty Center Linda që më ka bërë yll, Arjeta Palushajn për veshjet gjithashtu vëllain tim që me detaje ka parë çdo skenë të klipit që është fotograf si edhe Bledin e Max production që rri gati në çdo kohë.

KOHA: Dyshove në ndonjë çast se nuk do të mund ta realizoje ashtu siç duhej këtë klip?

Të them të drejtën kam qenë në çdo moment e acaruar (qesh), por ndihma e personave që përmenda më lart ma lehtësuan punën, (qesh).

KOHA: Më thuaj përshtypjen më të veçantë që more nga realizimi i tij...



Uhhh, e veçantë, e bukur, e lodhshme, e frikshme. Gjuajtja me armë me plumba të vërtetë, presion i madh psikologjik, eksperiencë e paharrueshme. Ndoshta do ta bëj përsëri! (qesh).

KOHA: Sa e shikon veten Silvana brenda këtij klipi?

Përveç armës që ishte gjë e re, aty 100% jam unë.

KOHA: Ku ndryshon ky klip nga klipet e tjera që ke realizuar?

Duke filluar nga titulli mendoj që ndryshon shumë duke qenë se unë kam ardhur gjithnjë e butë,



këtë herë mendova të vi me atë forcën e femrës që më karakterizon dhe që s'ma s'ndjen fare.

KOHA: Si do të jetë klipi i radhës? Apo është sekret...se me sa kam parë ti nuk e ke në plan të ndalesh...!

Klipi i radhës do jetë një surprizë e vërtetë për të gjithë, po punoj shumë s'ka pushim çdo gjë po mendohet mjaft mirë. Surprizë! Edhe për ty.

KOHA: Sa po e shijon famën e saj, Silvana?

Unë e kam thënë edhe herë të

tjera nuk dua famë dua thjeshtë të bëj atë që dua më së shumti. Po e them që po e shijoj për të ecur më tepër përpara po më frymëzon shumë.

KOHA: Çfarë bën për të qenë gjithmonë e suksesshme dhe e dashur për publikun?

Fjalë e madhe do thosha dhe faleminderit për këtë. Ajo që dua më së shumti është të jem e dashur për publikun, sigurisht dhe suksesi ka aksesin e vet në këtë pikë për të qenë e dashur. Unë e kam thënë dhe do vazhdoj ta them

se jam përherë vetvetja, këtë e thonë të gjithë, por koha vërteton ata që janë vetvetja zgjasin shumë, ti më njeh.

KOHA: Çfarë bën për t'u ndjerë gjithmonë mirë me veten, por edhe me të tjerët?

Që të ndihem mirë me veten, gjithnjë them te jesh vetja nëse familja më jep optimizëm unë jam e para që i jap vetes optimizëm dhe kjo më bën të ndihem mirë me veten time. Pastaj me të tjerët varet moj motër si të sillen.

KOHA: Silva, cilat janë vësh-tirësitë dhe anët pozitive të të qenit këngëtare?

Kjo pjesë është ajo që shumë nuk e din, kënaqësia më e madhe është duke qenë se bën atë që dëshiron më shumë dhe din ta bësh më së miri dashuria që jep dhe merr publiku, më e vështira është kur lodhesh vokalisht dhe të duhet të performosh ose kur të ndodh ndonjë incident me veshjet në skenë.

KOHA: Më trego diçka më shumë për jetën tënde të përditshme. Me çfarë merresh, përveç këngës?

Unë jam studente e marrëdhënies ndërkombëtare në universitetin European të Tiranës, kjo është ajo që bëj dhe këndimi live domethënë shkollë-pune. Edhe foto bëj për çdo dy ditë sete me vëllain, e kam çmendur.

KOHA: A ka Silvana ndonjë këngë të zemrës të cilën kur e këndon i dridhet shpirti?

Kam patjetër! Është pak e vjetër, por më rrëqeth Lara Fabian me "Adagio".

KOHA: Në fund, ndonjë merak të ngeli nga kjo intervistë?

Ndoshta, po e rikujtoj më në intervistën e ardhshme! Faleminderit shumë për suportin e të gjithëve atyre që më njohin dhe ata që më ndjekin në rrjetet sociale. Much love!

ADIS ISMAILI - SILLA

ARTI KËRKON PËRKUSHTIM KËMBËNGULËS

Costivari mund të jetë i vogël por ka shumë artist e një prej tyre është dhe Adisi, djaloshi që kompozon muzikën më të bukur shqipe të momentit. Ka bashkëpunuar me shumë artist të ndryshëm duke bërë kështu këngë hite e në studio e tij kanë kaluar shumë emra të njohur përfshirë këtu Vjollca Lukën, Miranda Hashanin e shumë të tjerë. Adisi vjen në një bisedë për InfraRed të gazetës KOHA për të zbuluar shumë gjëra, si nisi ky rrugëtim në muzikë!?

Koha Bisedoi: Blerand REXHEPI

KOHA: Artist dhe kompozitor shumë i njohur në trojet shqiptare, na zbuloni si ka lindur dëshira për muzikë?

Dashuria ime e parë ka qenë muzika, këtë e dëshmojnë dhe familjarët e mi dhe shpesh herë e përmendin që unë që i vogël kam pasur dëshirë të këndoj, vallëzoj dhe dëgjoj muzikë, me kalimin e kohës pasioni nuk u shua gjë që më detyroi të vazhdoj mësimet në shkollë të muzikës, pastaj në fakultet duke vazhduar të ndërtoj veten në këtë drejtim.

KOHA: Po në familjen tuaj familjarët si i kanë raportet me muzikën?

Sa i përket familjes unë rrjedh nga një familje që drejtimin bazë e kanë mjekësinë por kjo nuk ka qenë aspak problem për mua që të vazhdoj atë që dua, madje kam qenë unë tepër këmbëngulës për atë që bëj që të dëshmoj veten.

KOHA: A ke planifikuar në të ardhmen ndonjë nga fëmijët të trashëgojë këtë talent tëndin?

Nuk e di nëse fëmijët e mi do të kishin dashur të merren me muzikë, por patjetër që do t'i përrahja nëse do të donin të bëhen këngëtarë.

KOHA: Ndërmjet ushtrimit të një instrumenti dhe kompozimit, cili është ndryshimi emocional midis tyre?

Për mua ushtrimi i instrumentit ka qenë gjëja më e lodhshme dhe e bezdisshme kur kompozoj më duket se e bëj atë që dua ta bëj më tepër dhe që di ta bëj më së miri.

KOHA: Në ç'pozicion do t'i vendosnit këto koncepte në lidhje me muzikën tuaj dhe me mënyrën tuaj të të punuarit?

Në rend të parë është frymëzimi që ndez idenë dhe prej të cilës fillojnë gjërat, serioziteti është ai që mban disiplinën në punë sikur treni që rri në binarë dhe padyshim saktësia gjatë punës e cila është bërë problem dhe gjatë jetës së përditshme për shkak se më ka ngelur zakoni dhe dua që punët t'i bëj në perfeksion.

KOHA: Po kompozitori apo artisti shqiptarë ose i huaj që adhuroni në mënyrë të veçantë?

Eric Serra, James Horner dhe Richard Clayderman.

KOHA: Këshilla që do t'u jepnit të rinjve të sotëm, atyre që kanë ndërmend të nisnin rrugën e artit, atë të muzikës në veçanti?

Për të rinjtë të cilën duan të nisnin rrugën e artit kam një porosi: Nëse nuk mendoni gjatë gjithë kohës për atë që bëni, mos u merreni fare me të, arti kërkon përkushtim maksimal.

KOHA: Përveç muzikës, cilave pasione të tjerë u jepni prioritet në jetën tuaj?

Pas muzikës, pasion kam shëtitjen nëpër male.

KOHA: Cilat janë projektet e juaja të ardhshme profesionale?

Krahas projekteve me artist të ndryshëm jam duke punuar edhe albumin tim të parë, ky album do jetë i stilit dance - EDM dhe do të përmbajë tetë këngë me artist të ndryshëm duke përfshirë këngëtarë dhe instrumentist.

KOHA: A ka ndodhur ndonjëherë që të bësh gati komplet projektin muzikorë dhe këngëtarë të ju refuzojë?

Sikur të mos më kishte ndodhur nuk do isha këtu ku jam, por nuk jam dëshpëruar, por përkundrazi më ka shërbyer për të përmirësuar gabimet dhe të ndërtoj kualitetin tim.



METI BËRBA TOVCI

Këngët që përcjellin mesazhe

Ka vite që këndon, mirëpo muzikën e bën vetëm për hobi. Meti Bërbatovci, djaloshi nga Kosova që jeton në Zvicër, vjen në një rrëfim për InfraRed të gazetës KOHA duke treguar mbi projektin e fundit që e ka publikuar me titull 'Diagnoza' si dhe mbi rivalitetin në skenë si dhe pasionin e tij ndaj muzikës

KOHA: Cilat janë të rejtat me të cilat je shfaqur së fundi?

Po ka kaluar pak kohë që kam edituar këngën e re me klip 'Diagnoza', vet titulli i këngës tregon se është një këngë hidhërimi (qesh), pak hareshëm mirëpo jam ndarë shumë i kënaqur me këtë këngë e cila është punuar nga Wirusi, është këngë e shpirtit tim.

KOHA: Po imazhi i video-projektit a tregon ndonjë realitet?

Po, imazhi në klip tregon një realitet, një dashuri e humbur.

KOHA: A je duke punuar ndonjë projekt tjetër këto ditë?

Jo, për momentin kam pasur ndërmend të punoj një këngë të re bashkë me klip mirëpo kanë ndodhur disa gjëra dhe kam stopuar punimet, të shohim më tutje.

KOHA: Ke nisur me muzikë që në moshë të re?

Kam filluar që në shoqërinë kulturoartistike 'Trojet tona' pastaj në disa festivale dhe kështu me radhë.

KOHA: A ke konkurrencë në këtë profesion?

Jo, unë të paktën jo sepse nuk jetoj nga ky profesion, e kam thjeshtë hobi dhe e bëj për qejfin tim, më herët kam besuar në festivale derisa e kam provuar dhe e kam parë si shkon puna dhe tash nuk

kam ndërmend të marr pjesë në ndonjë festival pasi nuk janë korrekt.

KOHA: Këngët tua kanë ndonjë fabul në tekst dhe një mesazh?

Këngët e mia ato që i kanë dëgjuar kanë parë se kanë një domethënie secila ka një tekst e pikërisht kjo e fundit gjithashtu.

KOHA: Si e kalon një ditë ose një 24 orësh?

Një ditë me punë jam deri vonë, thuhet një javë në punë, vikendin pushim edhe pse kohës së fundit më shumë pushim për disa gjëra familjare.

KOHA: Më shumë je përkushtuar karrierës apo jetës?

Karrierën e shoh si një gjë të kohës që duhet jetuar një jetë normale, e kemi një jetë dhe duhet përfituar sat ë mundim nga ajo.

KOHA: Je dëshpëruar ndonjëherë në jetë?

Kurrë në jetën time nuk i kam ik realitetit edhe nuk do i iki edhe pse shumë herë jam dëshpëruar, mirëpo jam person që ja bëj vetes rrafsh (qesh).

KOHA: Sa beson tek dashuria në %?

Tek dashuria besoj 50/50%, realitet është ky.

KOHA: Lloji i tipit të mashkullit?

Jam tip i mashkullit që shikoj në të gjitha anët (qesh).



EVJOLA DAKA

PSE MË ZGJEDHIN VIP-AT PËR TË ZBUKURUAR VETULLAT?

Është një projekt që unë kam kohë që e kam nisur prej disa kohësh dhe ka qenë një përgatitje e madhe e voluminoze në punë, që mendohet të finalizohet shumë shpejt ku edhe do bëhet një pritje inaugurimi ashtu siç meriton edhe vlerësimi i punës...

Koha Bisedoi: Blerand REXHEPI

Evjola Daka është artistja shqiptare që merret me zbuturimin e një prej tipareve më të rëndësishme në formësimin e fytyrës, vetullën. Formësimi i saj është art më vete, por edhe trend duke qenë se në studion e Evjolës drejtohen jo vetëm njerëzit e zakonshëm, por edhe personazhe publike shqiptarë dhe jo vetëm. Ajo ka përfunduar shkollë speciale dhe kurse të ndryshme posaçërisht për këtë gjë, ndërsa më vonë edhe specializime për trajtime estetike. Pas përfundimit të studimeve, ka filluar me microbalding duke u bërë kështu edhe e parapëlqyera e të gjithëve. "Microbalding është punë dore, do të thotë punohet me dorë", thotë Evjola prandaj edhe konsiderohet si art më vete. Salloni i Evjolës që gjendet në Durrës, frekuentohet edhe nga emrat e njohur të showbizit shqiptar. Evjola na tregon se i është përkushtuar edhe një drejtim tjetër atë të fustaneve me qera, një projekt për të cilin ajo ka kohë që punon dhe shumë shpejt do jetë e finalizuar ku edhe do përurohet me një festë të madhe me të ftuar nga bota e showbizit shqiptarë, e këto e shumë gjëra të tjera ajo na i tregon në një bisedë për InfraRed të gazetës KOHA.

KOHA: Evjola për lexuesit e "Koha" që duan të dine më shumë, një nga tiparet që tërheq vë-



mendjen është vetulla apo jo. Ti si specialiste e kësaj fushe, sa zgjat aplikimi i metodës së fijeve tek vetullat?

Është e vërtetë që vetulla është një nga tiparet që bien më shumë në sy dhe që do kujdesin e saj për të qenë sa më e bukur dhe perfekte. Trajtimi i vizatimit të vetullave zgjat nga një deri një orë e gjysmë, vetëm aplikimi i ngjyrës zgjat 15 minuta ndërsa pjesa tjetër e kohës është për të përcaktuar formën dhe simetrinë.

KOHA: Vetulla ekzistuese mbetet pas trajtimit?

Absolutisht po, sepse me këtë metodë vetulla juaj as nuk hiqet as nuk pritet, thjesht hiqen ato fije që janë jashtë formës së dëshiruar, ndërsa pjesa tjetër mbetet dhe vizatimi bëhet në mes tyre.

KOHA: A ka një higjienë të caktuar që duhet mbajtur gjatë realizimit të procesit?

Higjiena është në nivelin më të lartë! Çdo gjë që përdoret gjatë punës përdoret vetëm një herë!

Nuk ekziston mundësia e shfaqjes së alergjisë në pigmente. Kur jemi këtu, duhet pasur kujdes me klientët sepse ke të bësh direkt me lëkurë, dhe mund edhe të sjellësh ndonjë problem të mundshëm.

KOHA: Cili është rezultati pas trajtimit?

Menjëherë pas trajtimit vetullat do të jenë të dendura dhe më të mbyllura nga ajo që kishim para se të trajtonim vetullën me këtë metodë. Mund të prisni 20-30% hapje të ngjyrës, dhe deri 10% zvogëlim të dendësisë dhe trashësisë pas kujdesit post-trajtimit. Pas 3-4 javëve përmes korrigjimit mund të përmirësohen parregullsitë e vogla, t'i shtohet ngjyra dhe dendësia, gjithmonë nëse është e nevojshme.

KOHA: Cila është këshilla jote më e madhe për femrat që duan të formësojnë vetullën dhe duhet të kenë kujdes?

Mos lejoni t'ju vizatojnë vetulla përmes formave të gatshme, ajo nuk ndodh tek kjo metodë, dhe

vetëm një joprofesionist do të ofroj atë! Drejtoheni gjithmonë tek njerëz të specializuar që dinë të bëjnë këtë metodë sipas standardeve!

KOHA: Evjola, i trembesh konkurrencës?

Unë mendoj se konkurrenca vetëm sat ë shton zellin për punë, sepse unë kam arritur që të krijojë besim e duhur tek klientet dhe fakti që kanë mbetur të kënaqura nga puna ime, ka qenë e pamundur që mos të vijmë përsëri ose mos të rekomandojnë dikë. Mendoj se puna e mirë nuk ka frikë asnjë konkurrencë.

KOHA: Po për çmimet janë të kënaqura klientet apo gjithmonë ka pakënaqësira?

Unë punoj me aparaturat e fundit dhe po ashtu edhe me produktet më të mira dhe më cilësore dhe mendoj se kam edhe tarifata më konkurse në treg duke pasur parasysh punën dhe cilësinë.

KOHA: Salloni yt "Fenix Studio" njihet si një nga studiot që frekuentohet më shumë prej personazheve publikë. A janë ata tekanozë apo acarues ndonjëherë?

Faleminderit për vlerësimin, po është e vërtetë, ndoshta prej faktit që studioja ime është ndër të parat e hapura dhe sigurisht që personazhet publikë më shumë se kushdo tjetër duhet të kujdesen për dukjen e bukur. Jo, të them të vë-

tetën personazhet që kanë ardhur në studion time kanë mbetur të kënaqur sepse i kemi ofruar të gjitha mundësitë për të gjetur at që i duhet. Personazhet shqiptarë, që për efekt të etikës profesionale nuk mund të them emra konkretë, janë shumë të dashur dhe më kanë lënë dorë të punoj ashtu siç duhet. Në fund kanë ikur të buzëqeshur dhe janë rikthyer po ashtu (qesh).

KOHA: Afërsia me klientët a është përparësi në punën tënde?

Po, kjo ndoshta edhe më karakterizon më shumë, afërsia me klientin dhe besimi për punën që e bëj. "Ne shqiptarët jemi më të afërt se sa të tjerët. Kemi pasur një rast kur një kliente kërkonte t'ia bëjmë një formë të vetullave, por ne e dinim se nuk do t'i dukeshin mirë. E këshilluam që t'i bënte në një formë tjetër. Ajo u bind dhe në fund ishte shumë e kënaqur si dhe na falënderoi për sugjerimin.

KOHA: Ndërkohë i je futur edhe një tjetër drejtim, atij të fustaneve me qera të mbrëmjes dhe jo vetëm apo jo?

Po është një projekt që unë kam kohë që e kam nisur prej disa kohësh dhe ka qenë një përgatitje e madhe e voluminoze në punë, që mendohet të finalizohet shumë shpejt ku edhe do bëhet një pritje inaugurimi ashtu siç meriton edhe vlerësimi i punës. Shumë shpejt do flasim edhe për këtë, por uroj dhe shpresoj të mirëpritet ashtu si edhe



ZAMIR GUTA

Koha tashmë ka nisur të ngrohet e në anën tjetër të rinjtë bëhen gati për të treguar paksa fizikun qoftë për t'u bërë gati për plazh, sepse afrohet edhe vera. Për të zbuluar disa sekrete, në një intervistë për InfraRed të gazetës KOHA, vjen fitnes-trajneri Zamir Guta, i cili në detaje zbulon shumë gjëra që duhet doemos t'i dimë mbi fitnesin

KOHA: E dimë se ushtrimet fizike janë të ndara në dy grupe: me peshë të trupit dhe me peshëngritje (tega), a mund të na tregoni cila nga këto është më efektive?

Trajnimi me peshë të trupit rrit muskujt të pastër më ngadalë dhe humb dhjamin e tepërt nga trupi.

KOHA: A do të thotë se për ndërtim më të shpejtë të muskujve dhe

definim të tyre, është më mirë të ushtrohet me peshë trupore?

Po normal që është më shpejtë me peshë, por një peshë e tepërt ose renf të zhvillon më shpejtë.

REXHINA ÇUKO

KJO ËSHTË AKADEMIJA E ËNDRRAVE TË MIA

Rexhina Çuko është balerina e njohur e ekranit e cila ka qenë pjesë e trupës së baletit në TV Klan dhe ishte pikërisht kjo eksperiencë që e bëri të nisë një rrugëtim ndryshe. Ajo çeli akademinë e saj të kërcimit ku edhe ka pasur shumë sukses. Realizoi një prej ëndrrave të saj më të mëdha por edhe u bë vendi i preferuar i të apasionuarve pas kërcimit. "Rexhina Dance academy" ka dyert e hapura për këdo që do kërcimin dhe do të zbulojë lidhjen e madhe mes artit të kërcimit dhe jetës e këto i rrëfen në një bisedë për InfraRed të gazetës KOHA



Koha Bisedoi: Blerand REXHEPI

KOHA: Një prezantim për lexuesit tanë, ti merresh me kërcim por prej sa kohësh?

Po, baletin dhe dansin sportiv e kam nisur që në moshën 6 vjeçare, pra kam shumë vite që merrem me këtë fushë.

KOHA: Pse fillove të merreshe me këtë fushë arti?

Sepse ky është pasioni dhe profesioni im që me jep jetë dhe më ushqen shpirtin.

KOHA: Kur të shkoi ndër mend të hapësh një akademi kërcimi?

Gjithmonë kam pasur dëshirë që të kem një akademi timen por iniciativa u mor nga ana ime pas eksperiencës në trupën e baletit në TV Klan.

KOHA: Kam parë që fton emra të njohur në fushën e kërcimit si Albi Nako dhe Ilir Shaqiri, më trego pak çfarë bëhet në sallë kur janë këta balerinë aty?

Salla mbushet me energji pozitive dhe dije pa fund për baletin, pasi secili prej tyre në atë sallë ka konceptin dhe interpreton zhanre të ndryshme, gjë e cila të pasuron në art.

KOHA: Në cilat disiplina zhvillohen kurset në Rexhina Dance Academy?

Disiplinat që zhvillohet mësimi janë këto: klasike në bazat e saj, moderne, jazz, latine, teknike kompetitive, popullore, musical, aktrim...



KOHA: A ka shumë kërkesa në Akademinë tënde?

Po, kemi shumë kërkesa dhe regjistrimet bëhen sipas klasave përkatëse në bazë të moshës dhe nivelit teknik. Janë 8 klasa por që gjithmonë ka vend për të rinj që duan të bëhen njësh me artin e kërcimit.

KOHA: Zakonisht në çfarë ore e fillon punën?

Mësimi fillon në orën 16:00 dhe mbaron në orën 20:00 çdo ditë

KOHA: Kë dikë që kujdeset për gjërat e tua përsa i përket kërcimit?

Po, gjatë orës së mësimi kam dy vajza asistente që më ndihmojnë, por më e rëndësishmja është mamaja ime e cila merret

edhe me menaxhimin e sallës.

KOHA: Përveç të kërcyerit bukur ka të bëjë dhe paraqitja e jashtme në këtë profesion, kostumet, detajet?

Sigurisht, veshja është bukuria e syrit që qëndis dhe lidh bukur mesazhin e kërcimit.

KOHA: Keni dhënë shfaqje në Shqipëri ose jashtë saj? Në çfarë vendesh keni lëvizur për të dhënë shfaqje?

Po, çdo vit kemi aktivitete. Mund të përmend aktivitetet e organizuara në Tiranë, në bashkinë Elbasan, Prizren dhe Itali ku fituam edhe dy çmime të para.

KOHA: Pas shumë vitesh në qoftëse do të kishe një vajzë, do doje që të bëhej kërcimtare si ty?

Të ketë shëndet se balerinë e bën mami, (buzëqesh) nëse do zgjedhë një profesion të tillë sigurisht.

KOHA: A ke ndonjë këshillë për vajzat që kanë dëshirë të merren me këtë fushë arti?

Këshilla ime do të shkonte më shumë për prindërit që t'i udhëheqin drejt ëndrrave të tyre, t'i mbështesin në ato që fëmijët kanë pasion. Ndërsa për vajzat që tashmë e kanë zgjedhur si profesion duhet shumë djersë, vullnet, durim dhe pasion. Sakrifiko dhe puno fort që të shpërblehesh!

FITNESI, DISIPLINË QË KËRKON PËRKUSHTIM

KOHA: Kemi dëgjuar shprehjen se muskujt e barkut ndërtohen në kuzhinë e jo në palestër, a mund të na tregoni si trajner fitnesi profesionist, sa e vërtetë është kjo thënie?

Punën e barkut normal të ushqimi është diku 70%, por sigurisht me ndihmën e ushtrimeve se pasha rrit dhe e zbkuron muskulin.

KOHA: Po shkojmë drejtë stinës së verës, ndërsa po rritet dhe dëshira për të ndërtuar një

trup të bukur dhe me muskuj brenda kësaj periudhe të shkurtër, a është e mundur për fillestarët?

Për fillestarët punën e fitnesit duhet të jetë trajnim 5-6 herë në javë me rregull me ushqim në nivel dhe deri diku edhe në 90 ditëshin një rezultat për të parë ndryshimin, thuajse diku 5 muaj stërvitje, dieta, ushqim dhe produkte të ndryshme.

KOHA: Çfarë ushtrimesh apo ushqimesh do t'u këshillohet

personave të cilët duan trup të definuar?

Ushqimi varet edhe nga metabolismi i njeriut, diku në ditë mund të ushqehet një ushtrues deri 6-7 herë, ndonjë gjë më kryesore si fara, oriz, pemë, supa, mish viçi, mish pule ose peshku.

KOHA: Cila është më e preferueshme gjatë ushtrimeve fizike: uji apo lëngjet e ndryshme?

Gjatë ushtrimeve varet tek personi se si e përballon tretjen e

një produkti por unë preferoj me ujë gjatë trajnimit.

KOHA: Duke marrë parasysh se jeni shumë aktiv edhe online dhe të hapur për personat, të cilët kërkojnë këshilla rreth kësaj fushe, sipas eksperiencës me këta persona, a mund të na tregoni cili është gabimi më i shpeshtë që bëhet nga fillestarët?

Gabimi është se gjithë fillestarët mendojnë shumë shpejtë të rikthehen ose të ndërtojnë një trup, fitnesi është sport si futbol-

li e basketbolli duhet të doni atë sport që të shkoni ngadalë derisa trupi e lyp peshën e rëndë e jo pesha trupin.

KOHA: A mund të bëhet shkurirja e yndyrës apo humbja e peshës edhe pa inkuadrinim e makinave kardiovaskulare në program?

Po mund vetëm me një peshë të lehtë, përsëritje më të shpeshta, pushim më pak, besoj që është edhe më efektive se kardio.

(B.R)

Si ka ndryshuar ecuria e tregtisë së Kosovës me shtetet e tjera, pas vendosjes së taksës mbi mallrat serbe. Humbjet që iu shkaktuan Serbisë dhe presioni i Europës dhe Amerikës mbi Kosovën. A po përfiton Shqipëria?

Më 6 shkurt 2019 u bënë tre muaj nga koha kur Qeveria e Kosovës vendosi taksën prej 10% ndaj mallrave serbe, e cila dy javë më pas, përkatësisht më 21 nëntor, u rrit në 100%. Vendosja e taksës ka pasur ndikime direkte në ekonominë e Kosovës dhe Serbisë. Shteti fqinjë ka pasur humbje të mëdha nga vendosja e taksës, ndërsa në tregun e Kosovës kanë zënë vend si asnjëherë më parë produktet vendase.

Taksa ka ngjallur edhe reagime të mëdha politike. Më e zëshmjia deri më tani, me reagime dhe presione, ka qenë Amerika. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Europian po kërkojnë urgjentisht heqjen e taksës. Kryeministri i Kosovës Haradinaj e ka refuzuar deri më tani heqjen e taksës, duke thënë se ajo mund të hiqet vetëm kur Serbia ta njohë Kosovën.

SERBIA HUMBI MILIONA EURO

Të dhënat e Agjencisë Statistike të Kosovës tregojnë se në dhjetor 2018, importet nga Serbia ishin vetëm 5 milionë euro, me një rënie drastike prej 88% në krahasim me të njëjtin muaj të një viti më parë. Edhe në nëntor, në fund të të cilit hyri në fuqi taksa, importet nga Kosova u përgjysmuan, në rreth 15 milionë euro. Mesatarisht, Kosova importonte nga Serbia çdo muaj mallra me vlerë 30-40 milionë euro.

Serbia, tradicionalisht ka qenë partneri kryesor i Kosovës, për sa u përket importeve, me rreth 13% të totalit për periudhën janar-tetor 2018, përpara se të hynte në fuqi kjo taksë. Këtë kryesisht ajo e humbi menjëherë në muajt nëntor-dhjetor. Ecuria e dobët në nëntor dhjetor

TAKSA 100% SI SHKAS

PSE NUK PO PËRFITON SHQIPËRIA NGA TORTA QË KOSOVA I HOQI SERBISË?



bëri që për gjithë vitin, importet nga Serbia drejt Kosovës të binin me 14%.

PRODUKTET E SERBISË MUND TË ZËVENDËSOHEN

Vendimi për taksën ndaj produkteve të Serbisë ka rritur edhe ndërgjegjësimin e qytetarëve për të mos blerë mallra serbe. Edhe bizneset janë solidarizuar me vendimin e Qeverisë së Kosovës. Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka pohuar për Monitor se bizneset kanë vënë interesin e tyre shtetëror para interesave private. Rukiqi thotë se taksa ka nxjerrë në pah nevojën që ka Kosova në riorientimin e tregtisë drejt vendeve të tjera dhe sa më pak nga Serbia.

Ai ka shtuar se çdo produkt që importohet nga Serbia është i zëvendësueshëm, qoftë nga prodhimet vendase apo nga ato të shteteve të tjera.

Edhe kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve, Agim Shahini, shprehet i bindur se Kosova mund t'i zëvendësojë pa vështirësi të mëdha produktet e Serbisë, qoftë nga

prodhimi vendas ose me produkte nga vendet e rajonit me të cilat ka raporte të mira.

Kryetari i AKB-së ka thënë se përveç raporteve zyrtare për importet nga Serbia, një pjesë e tyre futen edhe ilegalisht.

Partneri i parë i Kosovës për importet tashmë ka kaluar Gjermania (që tradicionalisht ishte e dyta), e cila zuri 13.1% të totalit në dhjetor, pavarësisht se me rënie të lehtë në raport me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Pas Gjermanisë renditet Turqia, Kina, Greqia, Italia, Maqedonia dhe më pas Shqipëria.

PRESIONI NDËRKOMBËTAR PËR TAKSËN

Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Europian në vazhdimësi po i bëjnë thirrje Qeverisë së Kosovës të tërheqë vendimin për taksën ndaj Serbisë.

SHBA ka thënë se nuk shohin ndonjë përfitim të Kosovës nga vendosja e taksës prej 100% për mallrat serbe. "Shtetet e Bashkuara kanë kërkuar prej lidershit të Kosovës në mënyrë të përsëritur që të pe-

zullojë menjëherë taksën për mallrat nga Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina. Siç kemi thënë, ne nuk shohim ndonjë përfitim të Kosovës nga këto masa. Ne fuqishëm inkurajojmë ripërtëritjen e fokusimit në qëllimet thelbësore të Kosovës—të ardhmen europiane dhe normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë", thuhet në një nga shumë reagimet që ka bërë deri tani Ambasada e Amerikës në Prishtinë ndaj qeverisë së Kosovës për taksën. Kurse Bashkimi Europian e ka cilësuar vendimin e Kosovës, për rritjen e taksës në 100% ndaj produkteve serbe, si shkelje të marrëveshjes së CEFTA-s. Kosova nga Serbia brenda një viti, së paku zyrtarisht, importon mallra në vlerë 400 milionë euro, por eksporton vetëm rreth 40 milionë euro për në serbi. Kosova ka vendosur taksën prej 10% më 6 nëntor për mallrat nga Serbia dhe më pas e ka rritur atë më 21 nëntor në 100%. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka përsëritur disa herë se taksa do të hiqet në momentin kur Serbia të njohë shtetin e Kosovës.

EKSPORTET NGA SHQIPËRIA DREJT KOSOVËS RRIEN 35%, A NDIKOI TAKSA

Shqipëria ka eksportuar në vitin 2018 mallra e produkte me vlerë prej rreth 206 milionë eurosh në Kosovë, duke shënuar nivelin më të lartë historik, sipas të dhënave të publikuara nga Agjencia Statistike e Kosovës. Në raport me një vit më parë është shënuar rritje e ndjeshme prej 35.6%. Por të dhënat e detajuara mujore dhe sipas kapitujve, tregojnë se kjo rritje lidhet më shumë me gjallërimin e aktivitetit të kompanisë shqiptare të prodhimit të çelikut Kurum, e cila në 2018-n rriti ndjeshëm aktivitetin dhe eksportet, pasi doli me sukses nga një procedurë falimentimi e nisur në mars 2016.

Këtë e tregon dhe fakti që në dhjetor, eksportet nga Shqipëria drejt Kosovës ishin 17 milionë euro, nga 22 milionë euro që rezultuan në gusht, kur nuk kishte hyrë në fuqi taksa me Serbinë. Ky grup zë 41% të eksporteve shqiptare drejt Kosovës, sipas INSTAT. Kosova është një nga destinacionet kryesore të eksportit për Kurum dhe kërkesa ka qenë në rritje si rrjedhojë e ndërtimeve rezidenciale dhe projekteve të mëdha të infrastrukturës. Eksportet e Gizës dhe çelikut nga Shqipëria në Kosovë u rritën me 52% në 2018-n.

Grupi i dytë me rritjen më të lartë është ai i lëndëve djegëse minerale, me 15% të totalit. Ky grup shënoi rritje prej gati 80% të eksporteve në 2018-n. Ndërsa "Alumini dhe artikuj prej tij" dhe "Zarzavatet" ranë përkatësisht me 7% dhe 0.3% me bazë vjetore.

Ecuri pozitive kishin eksportet e "mobiliere dhe dyshekë", me një zgjerim prej 40%. /Monitor.al/

DEPUTETËT E PD LËNË MANDATET

JA PESË ARSYET QË NA DETYRUAN

Pasi morën edhe mbështetjen unanime të Këshillit Kombëtar për djegjen e mandateve, deputetët e partisë demokratike nisën firmosjen e formularëve të dorëheqjes.

I pari që nënshkroi ishte ish kryeministri Sali Berisha i ndjekur nga Lulzim Basha dhe të tjerët. Drejtues të PD thanë se dokumenti po firmoset edhe nga të gjithë kandidatët e tjerë të që kanë qenë në lista.

I njëjti proces nisi edhe tek lëvizja socialiste për Integrim. Krye-

tarja Monika kryemadhi firmosi e para e pas saj edhe deputetët e tjerë të LSI.

Ndërkohë, lideri demokrat Basha tha se neser deputetët do të dalin në proteste si qytetarë të thjeshtë.

"28 vite pas rrëzimit të simbolit të diktaturës më të eger që ka përjetuar Evropa, shqiptarët do kenë në krah Partinë Demokratike për të vendosur në Shqipëri s'do ketë kurrë më një regjim diktatorial. Vnedit do t'i rikthehen zgjedhjet e lira dhe të

ndershme. Parlamenti s'do jetë më strehë e krimin por tempulli i demokracisë. Pas urdhërit në protestën më të madhe në Shqipëri, ne vendosëm t'i bindemi. Përmes një vendimi të paprecedentë ne kemi vendosur të çojmë deri në fund betejën tonë europiane. Ajo derë do hapet vetëm kur vendi të ketë zgjedhje të lira dhe kur ndarja e pushteteve të garantojë një qeverisje të përgjigjshme."

Basha i beri thirrje qytetarëve që ti bashkohen protestës së ditës



së enjte para selisë së parlamentit.

Të gjitha deklaratat e dorëheqjeve të deputetëve do të dërgohen nesër kuvendit, i cili pas verifikimit

të tyre ne komisionin e mandateve, ka një muaj kohë për tia përcjellë komisionit qëndror të zgjedhjeve. /Vizion Plus

KURZ DHE TRUMP: NËSE KOSOVA E SERBIA ARRIJNË MARRËVESHJE, MOS T'UA ZËMË RRUGËN

Kurz ka bërë të ditur se Trump kërkoi që Austria ta rrisë buxhetin për ushtrinë. "Besoj se administrata amerikane ka interes për marrëdhënie të mira por në shumë pyetje kemi mendime të ndryshme", theksoi ai në lidhje me takimin me Trumpin

Kancelari austriak i tha presidentit amerikan, se Austria mund ta mbështes edhe shkëmbimin e territoreve, nëse arrihet marrëveshje mes Serbisë dhe Kosovës, transmeton Gazeta Metro.

Kancelari austriak Sebastian Kurz është takuar me presidentin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump.

Në takimin e tyre të zhvilluar në Uashington, ata diskutuan



edhe për çështjen e Kosovës. Kurz është kancelari i parë i Austrisë i cili në Shtëpinë e Bardhë u takua me një president të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në 13 vitet e fundit.

Pas takimit, ai ka thënë se SHBA-të në Kosovë "kanë ndikim të madh që mund ta përdorin pozitivisht".


Kurz theksoi se Austria pozitivisht sheh dialogun mes presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq dhe presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi dhe se mund ta mbështes edhe shkëmbimin e territoreve edhe pse bëhet fjalë për një temë të ndërlikuar.

"Nëse dy palët arrijnë marrëveshje për diçka, nuk duhet t'u

qëndrojmë në rrugë, as evropianët as amerikanët", porositi ai.

Kurz ka bërë të ditur se Trump kërkoi që Austria ta rrisë buxhetin për ushtrinë.

"Besoj se administrata amerikane ka interes për marrëdhënie të mira por në shumë pyetje kemi mendime të ndryshme", theksoi ai në lidhje me takimin me Trumpin.



Viktimat e abuzimit seksual nga Kisha kërkojnë reforma

Shumica e klerëkëve dhe Bishopëve të kishës katolike në Vatikan e konsiderojnë përdhunimin më shumë si "mëkat" se sa si krim, prandaj me shumë gjasë nuk do të ketë ndryshime në sistemin kishtar edhe pas lajmit që priftërinjtë kishin abuzuar me mortat murgesha, transmeton Zeri.info.

Disa të tjerë, përdhunimin e murgeshave ia kanë atribuar homoseksualiteti, transmeton Zeri.info.

Teksa Papa Françesku ka kërkuar një takim urgjent për t'i adresuar lajmet shokuese, viktimat e abuzimit kanë kërkuar që të bëhen ndryshime rrënjësore në sistemin kishtar dhe të krijohet një kontratë me zero toleranë ndaj rasteve të priftërinjëve që abuzojnë fëmijë e murgesha.

Gjithsesi, zyrtarët e Vatikanit thonë se një kërkesë e tillë reflekton një ide të gabuar se ndryshimi në një institucion global dhe kaq të lashtë mund të bëhet me valën e një shkopi papal.

Shumëllojshmëria e pengesave ligjore dhe kulturore për identifikimin e abuzuesve dhe ndihmës ndaj viktimave, si dhe mohimi i ngulitur, bën të mundur vendosjen e një standardi botëror pothuajse të pamundur, thonë ata.



Kanadaja hap dyert, 1 milion emigrantë të rinj do pranohen deri në vitin 2020

Kanadaja nuk ka hequr dorë nga plani për të mirëpritur 1 milionë emigrantë të rinj përgjatë viteve 2019, 2020, 2021, përkundrazi është duke marrë masa konkrete që ta zbatojë këtë projekt.

Mediat e medha në këtë vend shkruajnë se parlamenti kanadez ka njoftuar planin për të shtuar më shumë mbi 1 milion banorë të përhershëm gjatë kësaj periudhe, e cila përbën gati 1% të popullsisë së vendit çdo vit. Në vitin 2017 në Kanada shkuan 286 mijë banorë të përhershëm, ndërsa përgjatë 2018 ishte parashikuar një shifër prej 350 mijë banorësh, e cila më pas në 2020 pritet të shkojë në 360 mijë. Fluksi i emigrantëve do të ndihmojë në kompensimin e popullsisë së vjetër të Kanadasë, duke rritur kështu fuqinë e saj të punës. Qëndrimi miqësor i Kanadasë ndaj banorëve të rinj vjen si një nismë e shumë vendeve të tjera perëndimore.

Rusia do të instalojë në korrik sistemin raketor S-400 në Turqi

Ministria turke e Mbrojtjes tha sot se Rusia do të bëjë dërgesën e aprë të sistemit mbrojtës raketor në Turqi në korrik dhe do ta aktivizojë atë në tetor.

"Dërgesa e sistemit S-400 do të nisë në korrik, dhe në tetor sistemi do të jetë aktiv," tha në një intervistë Ismail Demir, kreu i sekretariatit turk për industrinë e mbrojtjes.

"Janë dy sisteme të tilla, dhe për të dytin kalendari ka ndryshuar, por nuk ka asnjë problem", shtoi ai.

Turqia ka nevojë për më shumë se dy sisteme të mbrojtjes raketore, prandaj është gjithashtu në negociata me SHBA për blerjen e sistemit amerikan tokë-ajër Patriot, shtoi Demir.

Gjithsesi ai tha se Ankaraja nuk mund të zbulojë për momentin detajet e ofertës amerikane.



Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan tha në fundjavë se SHBA nuk mund të plotësojë dy nga kushtet e Turqisë për blerjen e sistemit Patriot, në lidhje me kreditimin dhe prodhimin e përbashkët.

Turqit ia ndërrojnë vendin xhamisë e cila peshon 4,600 ton

Pjesa e fundit e Xhamisë Eyyub, e që peshon 2,650 ton, është bartur në vendin e saj të ri me anë të mjetit SPT me 352 rrota, nga vendi historik Hasankeyf.

Procesi i punës thuhet se ka zgjatur rreth 6 orë, ndërsa rruga është rreth 6 kilometra deri në Parkun e Ri Kulturor.

Procesi i bartjes së Xhamisë Eyyubi filloi më 26 nëntor. Në fushën e transportit, pjesa e parë e mureve të kopshtit që peshonin 115 ton ishin zhvendosur në 6 pjesë. Një vepër kolosale guri e quajtur Zeynel Bey Shrine u zhvendos duke përdorur teknologji të ngja-



shme vitin e kaluar.

Ky veprim vjen pasi diga e

katërt më e madhe e Turqisë është në rrezik dhe qyteti i lashtë

i Hasankeyf rrezikohet nga përmytjet e ujrave

Më 6 shkurt 2014 muzika shqiptare mbeti pa mbretëreshën e saj. Vaçe Zela ndërroi jetë në Bazël të Zvicrës duke lënë një boshllëk të madh në muzikën dhe artin shqiptar. Në këtë katër vjetor, i vëllai i saj Hysni Zela, dha një intervistë interesante për gazetarin Roland Qafoku në emisionin "Debati në Channel One" duke ndarë shumë emocione, por edhe fakte dhe detaje që vijnë për herë të parë

VËLLAI RRËFEN SEKRETET E VAÇE ZELËS: E QUAJTËN TË PAAFTË



Rrefimi i vëllait, Hysni Zeles "Vaçen nuk e shpallën fituese të konkursit për në Lice, e quajtën të paaftë! Është një humbje e madhe. Nuk humba vetëm unë motrën dhe familja jonë njeriun e dashur. Por është një humbje e madhe për të gjithë muzikën dhe kulturën shqiptare veçanërisht për popullin. Është rasti të them se nuk ka një njeri që e zbuloi talentin e saj. Vaça zbuloi veten në shtëpinë tonë në Lushnje, se ne kemi lindur të gjithë në Lushnje. Madje ka një fakt interesant.

Vaça lindi ditën që Italia pushtoi Shqipërinë, por nuk e përmendin këtë dhe vitin e lindjes ia shënuan me qëllim në 1938. Kisha një bahçe përpara shtëpisë dhe Vaça aty këndonte çdo ditë dhe imagjinoni edhe pse ishte fëmijë ajo bënte vokalica. Këndonte çdo lloj këngësh, shqiptare e të huaja. Nisi të këndonte në shtëpinë e pionierit në qytetin e Lushnjes dhe aty spikati. Aty u zbulua si talent dhe e kërkuan të vinte në Tiranë. Erdhi në Tiranë në moshën rreth 15 vjeçare dhe filloi shkollën.

Në fakt në fillim konkurroi për në Liceun Artistik por për habi nuk fitoi konkursin duke e nxjerrë të

paaftë. Kur e kanë marrë në pyetje ka qenë në komision Marie Kraja. Bashkë me të ka qenë edhe një soprano bullgare. Ka shumë mundësi që bullgarja të ketë menduar se Vaça nuk ka qenë për muzikë lirike dhe kjo duhet të ketë qenë arsyeja që nuk ia ka dhënë konkursin.

Më pas Vaça kreun gjimnazin "Qemal Stafa" dhe më pas fitoi konkursin për në institutin e Arteve në degën dramë. Por e ndërpreu pasi mbaroi vitin e dytë dhe nuk u diplomua. Madje ka luajtur edhe një dramë. Ajo e ndërpreu shkollën edhe me arsyen se duke qenë familje e varfër dhe me shumë fëmijë të gjithë ushqimet ti merrte Vaça. Ishte momenti që ajo bëri shkëputjen e madhe si këngëtare dhe ajo nuk mund të ishte edhe aktore edhe këngëtare. Kënga ishte ajo që qëllon në shenjë.

Pak kohë pasi erdhi në Tiranë ajo na mori të gjithë familjen të 6

fëmijët dhe prindërit. Tiranë na dukej si Amerika. Kur shikonim një makinë me targën LU ngazëlleshim. Kam dëgjuar që disa thonë se jemi me orgjinë nga Kosova. Unë nuk e di këtë, mund të jetë e largët por nuk e di. Unë di që jemi lushnjarë autoktonë aty kemi qenë prej shumë e shumë kohësh. Ne merreshim me bujqësi. Babai e shiti shtëpinë kur erdhëm në Tiranë. Ishim shumë të varfër dhe jetonim me prodhimet e tokës që e punonin prindërit. Vaça e vogël vizitonte shpesh tokën ku punonin prindërit por ishte e vogël dhe nuk punonte.

Për vdekjen "Ishte një humbje e madhe. Vaça shkoi pas viti 1990 në Zvicër te e bija. Ajo kishte mundësi jetese më të mirë dhe Vaça duke qenë e sëmurë ishte nën kujdesin shëndetësor. Sivjet u mbushën 4 vjet nga humbja e Vaçes. Vaça vdiq në Bazël, por si-

pas amanetit e varrosën në Tiranë. E bija Irma dhe bashkëshorti Pjetër herë pas herë vijnë në Tiranë. Madje duhet të themi se këtë varr të veçantë Irma ia ka sjellë nga India. Më kujtohet një koncert që Vaça dha në Greqi. Kthjem vizitën këngëtares Marinela. Ajo vetë ishte në sallën me 2 mijë spektatorë. Kur këndoi Vaça këngën e saj në greqisht salla u ngrit në këmbë.

Shfaqja mbaroi dhe Vaça shkoi direkt në garderobë. I afrova dhe ajo mbylli derën. Ishte bërë e bardhë borë. U tremba shumë. Duket se i harxhoi të gjitha turbinat e trupit. Aty pashë që për herë të parë pështy gjak. Kishte kaluar moment shumë të forta. Ndoshta aty ka nisur sëmundja e saj.

Tri këngët që këndova me Vaçen Nuk e kam pasur kurrë atë që thonë disa hija e Vaçes ose që më quanin vëllai i Vaçes. Unë e kam pasur për nder që isha dhe

jam vëllai i Vaçe Zelës. Nuk ka vend për krahasim dhe epitete të tilla. Kam provuar emocione të forta. Kam kënduar me Vaçen vetëm tre duete. Por ato emocione nuk i kisha provuar kurrë. Madje përgjegjësia ishte shumë e madhe. Edhe pse ishte motra ime kjo më bënte shumë herë më të përgjegjshëm. Në këngën e parë që kënduam bashkë atë të Myzeqesë, unë kisha shumë emocione. Madje strofën e tretë e këndova të dytën. Ajo më hodhi dorën në sup si mbështetje por mua mu duk si një vërejtje. E kalova këtë siklet vetëm për faktin se strofa e tretë nuk kishin dallim me strofën e dytë dhe askush nuk e kuptoi.

Të lëndoje me Vaçen ishte fat i madh. Shumë më pyesin përse vetëm 3 këngë këndova me të. Vaça thoshte kaq, mjafton. Nuk duhet ta teprojmë. Ajo ishte shumë e zgjuar dhe e dinte masën. Kur në Zvicër realizuam një koncert enkas për Vaçen ishte një moment i veçantë për mua. Përpara se të nisja të këndoja i putha dorën. Ishte kënaqësi e madhe. Dhe një mirënjohje e madhe për udhërrëfyesin tim Për këngët e sotme "Sot këndojnë ma jep ta jap" Teksti i këngës "Lemza" është shumë i bukur. Dëgjoni: Ç'më kujton kaq shpesh mor djalë Lemz or lemz më ler të qetë Është turp i madh kur s'di një fjalë Edhe lemza kisha mbet Por sot nuk kam dëgjuar tekste të bukura. Nuk po e shohim më artin që kemi bërë dikur. Sot në tekste ka fjalë të tilla ma jep ta jap. Nuk arrij ta besoj.

Dua Lipa shpërblehet me çmimin "Kënga më e mirë e vitit" në 'Brit Awards'

Dua Lipa, ka rrëmbyer çmimin për këngën më të mirë të vitit. Këngëtarja shqiptare edhe këtë herë është shpërblyer me çmim në "Brit Awards 2019", bashkë me Calvin Harris. Kënga "One Kiss", e Dua Lipës në duet me Calvin Harris u zgjodh "Kënga më e mirë e vitit".

Dua u ngjit në skenë për ta kënduar 'live' këtë këngë, pak para se të merrte çmimin, i cili vjen pas dy çmimeve 'Grammy' që ajo mori javën e kaluar. Nga ana tjetër, Calvin Harris u nderua me çmimin 'Producenti i vitit' në mbrëmjen e "Brit Awards 2019".

Vetëm një vit më parë jetonte në një banesë modeste me qira, ndërsa sot dominon muzikën botërore: ky është thelbi i artikullit të "The Sun" kushtuar këngëtares shqiptare Dua Lipa, e cila u bë për të dytin vit radhazi artistja më e no-



minuar në "Brits Awards" për të dytin vit radhazi e të premtën, iu kushtua dhe një figure dylli në Madame Tussauds të Londrës.

Të gjitha këto kur vetëm pak kohë më parë, 23 vjeçarja jetonte me familjen e saj në një banesë të ngushtë në Londër, thuhet në artikull.

"The Sun on Sunday" ka kontak-

tuar me miqtë e këngëtares dhe ish-fqinjët e saj për të biseduar lidhur me rrugëtimin e jashtëzakonshëm të vajzës së refugjatëve nga Kosova drejt famës, transmeton "TCH".

Një mikeshë e saj, Zana Veseli, të cilën Dua e njeh që fëmijë, ka pohuar për gazetën e njohur britanike se fama nuk e ka ndryshuar

këngëtares e bukur, përcjell albinfo.ch.

"Dua është personi i njëjtë që ka qenë gjithmonë. Gjatë gjithë jetës ka dashur të bëhet yll i muzikës pop. Është e mrekullueshme që po fiton aq shumë çmime", citohet të ketë thënë ajo.

Më tej, "The Sun" tregon për largimin e familjes së Duas nga Ko-

sova në vitin 1992, si pasojë e shtypjes së popullatës shqiptare nga regjimi serb, dhe rikthimin në atdhe kur këngëtarja ishte 11-vjeç. Katër vjet më vonë megjithatë ajo do të zhvendosej serish në Londër e në 2012-tën, do t'i bashkoheshin dhe të afërmit me të cilët jeton sot në një shtëpi luksoze në Kilburn të Londrës Veriore.



“Kur unë luajta me të, ai ishte lojtar i ri dhe tani e ka ngritur nivelin e tij për shumë shkallë. Ai e pati një periudhë të vështirë kur nuk po aktivizohej shumë në ndeshjet, kur ishte lojtar i Bayernit dhe Interit”, ka thënë Barnetta

SHAQIRI I KA HESHTUR KRITIKËT NË LIVERPUL



Bayern Munichut, në kuadër të 1/8 të finales. Megjithatë, Barnetta, i cili kishte luajtur bashkë me Shaqirin në ekipin kombëtar të Zvicrës deri në vitin 2014, kur u pensionua,

mendon se futbollisti me origjinë nga Kosova e ka dëshmuar talentin e tij për Kloppin. “Kur unë luajta me të, ai ishte lojtar i ri dhe tani e ka ngritur nivelin e tij për shumë

shkallë. Ai e pati një periudhë të vështirë kur nuk po aktivizohej shumë në ndeshjet, kur ishte lojtar i Bayernit dhe Interit”, ka thënë Barnetta. “Për këtë arsye, jam shumë i lumtur që ai shkoi në Liverpool dhe i shfrytëzoi të gjithë mundësitë që i erdhën. Ndoshta shumë njerëz nga jashtë mendonin: ‘Çfarë po bën ai në Liverpool pas Stoke City?’”. “Por, ai nuk reagoi ndaj këtyre deklaratave dhe i bëri disa paraqitje të mrekullueshme. Tani, mendoj se të gjithë personat e jashtëm kanë heshtur”. “Ai [Klopp] është një motivues i mirë dhe ai e përjeton futbollin. Për këtë arsye, besoj se ai e nxjerr më të mirën nga lojtarët. Mendoj se Xherdani kishte nevojë për këtë gjë sepse, siç thashë, ai gjithmonë ka pasur talent, por nuk arrinte ta dëshmonte këtë nganjëherë në fushë”. “Gjatë muajve të fundit, ai ka shfaqur se çfarë mund të bëjë. Ishite shumë e rëndësishme që ai të mos aktivizohet menjëherë dhe tani, në muajt e fundit, na ka treguar se çfarë mund të bëjë”.



Kelmendi i kthehet garave në Grand Slamin e Dusseldorfit

Kampionia Olimpikë, Majlinda Kelmendi, do të rikthehet të premten në gara, pas pushimit që bëri në Grand Slamin e Parisit. Heroina jonë do të garojë në Grand Slamin e Dusseldorfit, që mbahet prej të premtes deri të dielën. Majlinda, e cila do të garojë të premten në kategorinë e saj deri në 52 kilogramë, është garuesja e vetme që do të përfaqësojë vendin tonë, pasi xhuditstët tjerë, Akil e Nora Gjajkova, Distria Krasniqi dhe Loriana Kuka, do të pushojnë. Grand Slami është gara e dytë këtë vit për medalisten e artë Olimpikë, pas medaljes së artë të fituar muajin e kaluar në Grand Prixin e Tel Avivit. Në këtë Grand Slam marrin pjesë 683 garues nga 97 shtete, ndërsa Grand Slami është i vlefshëm për pikë Olimpikë Tokio 2020. “Dusseldorf është një ndalesë vendimtare në rrugën drejt Lojërave Olimpikë Tokio 2020 dhe kampionatit botëror të xhudos që mbahet në Tokio këtë vit. Kampionët Olimpikë dhe të botës do të garojnë në Gjermani, ku tifozët e xhudos mund të presin një garë spektakolare”, ka deklaruar presidenti i Federatës Ndërkombëtare të Xhudos, Marius Vizer, për “ijf.org”.

Seferi shënon gol në fitoren e Uinterthurit


Shkup, 21 shkurt - Taulant Seferi është pikë referimi te skuadra zvicerane e Uinterthur. Në takimin përballë Rapersvil, Seferi luajti nga minuta e parë, duke u bërë dhe protagonist. Ish-sulmuesi i Shpresave kuqezi shënoi golin e dytë dhe atë vendimtar për skuadrën e tij, në minutën e 89' të sfidës. Ky ishte goli i shtatë në kampionat për Seferin, që është dhe golashënuesi më i mirë për skuadrën e Uinterthur. Kjo fitore e afron edhe më shumë Uinterthurin me vendet e para në renditje, pasi ngjitet në kuotën e 37 pikëve, po aq sa ka dhe Lozana e vendit të dytë.



Ujkani ka prekur pikën më të ulët në karrierë

Pak ditë para se të niste pjesa pranverore në Superligën e Turqisë, kapiteni i Përfaqësueses së Kosovës, Samir Ujkani, në një intervistë për mediet italiane tha se nuk është i kënaqur te skuadra e Rizesporit për shkak të minutazhës së vogël në pjesën vjeshtore. Mirëpo, kur tha këtë ai nuk kishte paramenduar se situata e tij tek ekipi turk në pranverë do të vështirësohej edhe më shumë. Ujkani tashmë është larguar nga ekipi i parë dhe në pesë ndeshjet e para të pjesës pranve-

rore nuk ishte as në stol. Atij i është thënë nga klubi se për shkak të numrit të kufizuar të lojtarëve të huaj nuk mund të përfshihet në 18-she, kështu që deri në fund të edicionit do të mbetet jashtë ekipit të parë. Ujkani 30-vjeçar ka pasur një karrierë me shumë rënie-ngritje. Problemet gjithnjë e kanë përcjellë, por asnjë si ky te skuadra turke. Në një intervistë për gazetën ka thënë se e ka pranuar vendimin, të cilin nuk e ka pritur. Por ka shtuar se kjo nuk e ka demoralizuar,



por motivuar që të vazhdojë të punojë me përkushtim në stër-

vitje për të mbajtur formën e tij deri në fund të edicionit.



Jusufi transferohet te Shirak

Shkup, 21 shkurt - Futbollisti, Fatjon Jusufi karrierën e tij futbollistike do ta vazhdojë se ekipi armen Shirak. Përndryshe 23 vjeçari është fëmijë i skuadrës së Renovës. Nga ekipi i “gjijspunuesve” Jusufi u largua në janar, ku firmosi me skuadrën e Partizanit nga Tirani, por si duket transferi nuk u realizua deri në fund dhe kështu destinacioni i radhës për Fatjonin është Armenia. Ndryshe tek skuadra e Shirak lidhet edhe Bunjamin Shabani, i cili më herët ka qenë pjesë e Milanos, Renovës dhe Shkupit. (FN)

Herrera është bërë i pazëvendësueshëm në skuadrën e Ole Gunnar Solskjaer. Mesfushori spanjoll ka qenë njëri ndër yjet e "Djajve të kuq" që nga shkarkimi i Mourinho, në dhjetor. Shtatë nga 13 paraqitjet si titullar në këtë sezon të Premierligës, ai i ka bërë me norvegjezin

HERRERA, HEROI I PANJOHUR I RINGJALLJES SË UNITEDIT




Ander Herrera është shpirti dhe zemra e Manchester Unitedit, dhe dalëngadalë ai po e fiton mirënjohjen që e meriton. Paul Pogba, Marcus Rashford dhe Anthony Martial – paraqitjet e këtyre i kanë dominuar ballinat e gazetave gjatë ringjalljes së Manchester Unitedit. Por, skuadrën e Manchester Unitedit po e drejton një hero i panjohur: Ander Herrera, shkruan AS. Herrera është bërë i pazëvendësueshëm në skuadrën e Ole Gunnar Solskjaer. Mesfushori spanjoll ka qenë njëri ndër yjet e "Djajve të kuq" që nga shkarkimi i Mourinho, në dhjetor. Shtatë nga 13 paraqitjet si titullar në këtë sezon të Premierligës, ai i ka bërë me norvegjezin. "Energjia dhe natyra e

tij këmbëngulëse është tejet e rëndësishme për ne. Dhe kjo është arsyeja pse ai luan, pak a shumë çdo ndeshje. Ai ka shumë energji, mund ta mbulojë një hapësirë të madhe të fushës dhe vrapon përpara. Nuk mund ta lavdërosh vetëm dikë, janë 11 lojtarë në fushë, por Anderi ka bërë punë të mrekullueshme", tha Solskjaer, pas fitores kundër Chelseat. Për shkak të durimit dhe përkushtimit që ka

Herrera në fushën e lojës, shumë tifozë të Manchester Unitedit tani po kërkojnë që ai të bëhet kapiteni i skuadrës. Sezonin e kaluar, ai i kishte bërë vetëm 13 paraqitje si titullar. Edhe pse është rritur në Spanjë, Herrera është po aq i pasionuar pas Manchester Unitedit sa edhe lojtarët e akademisë së klubit. Sezonin e kaluar ai kishte vuajtur nga transferimi i Nemanja Maticit, ndërsa këtë sezon pritet

që situata e tij të bëhet edhe më e vështirë për shkak të transferimit të Fredit. Mirëpo, ashtu si Pogba, Rashfordi, Martiali dhe të tjerët nën drejtimin e Solskjaer, Herrera është duke shkëlqyer në Old Trafford. Me Herreran në skuadër, Manchester Unitedi i fiton mesatarisht 71.4 për qind të ndeshjeve, ndërsa pa të vetëm 40 për qind. Herrera është duke përfituar nga stili i ri i lojës së Manchester Unitedit, më sulmues. 29-vjeçari tani po e shfaq aftësinë e tij për të pasuar dhe për t'u përfshirë në aksione të sulmit. Përderisa nën drejtimin e Mourinhos, në ndeshjet kundër Chelseat, Herrera e kishte detyrën për t'i shkuar pas Eden Hazardit, në ndeshjen e fundit me Solskjaer, atij iu dha një rol më i lirë. Herrera nuk e ka famën apo aftësitë e Pogbas për të dribluar. Megjithatë, ai është zemra dhe shpirti i Manchester Unitedit pasi që sjell barspeshë në një skuadër të mbushur me lojtarë që duan të sulmojnë.



Rakitic arrin marrëveshje me Interin

Ivan Rakitic është pajtuar t'i bashkohet Interit në verë, për shkak se e ardhmja e tij në Barcelonë është tejet e pasigurt. Sipas Gazzetta dello Sport, Interi dhe Barça janë në bisedime për arrijtjen e një marrëveshjeje. Barcelona e ka blerë Frenkie de Jongun në janar, dhe holandezi do t'i bashkohet klubit në verë, si dhe është buzë arritjes së një marrëveshjeje me Adrien Rabiotin e Paris Saint-Germainit, i cili është i lirë të bisedojë me klube tjera për të ardhmen e tij pasi refuzoi ta vazhdojë kontratën me gjigantin e Ligë 1. Kjo nënkupton se mundësitë e Ivan Rakicit për ta ruajtur vendin e titullarit në skuadrën e Ernesto Valverdes janë pakësuar. Gazeta italiane raporton se Interi i ka ofruar mesfushorit kroat pagë vjetore prej 6 milionë euro, më shumë sesa që ai merr te kampioni spanjoll (5.5). Po ashtu, zikaltrit i kanë ofruar klubit katalonas 35 milionë euro për shërbimet e tij, por Barça këmbëngul me kërkesën e saj për 45 milionë euro. Besohet se palët mund të arrijnë marrëveshje për një shumë në vlerë 40 milionë euro.



Emery reagon ndaj Wengerit për Mesut Ozilin

Unai Emery ka thënë se Mesut Ozili është duke punuar zellshëm në stërvitje, një ditë pasi ish-trajneri i Arsenalit, Arsene Wenger, e vuri në pikëpyetje nivelin e përpjekjeve të mesfushorit. Wenger tha së fundmi se vendimi për t'i ofruar Ozilit kontratë afatgjatë vitin e kaluar mund të ketë ndikuar në gjermanin që të mbetet në zonën e tij të rehatisë. Ozili nuk është duke gjetur vend në ekipin e parë të Unai Emeryt këtë sezon, i cili erdhi në stolin e Arsenalit pas largimit të Wengerit në maj. Emery i ka kundërshtuar komentet e Wengerit se Ozili nuk po bën përpjekje për të qenë në nivelin e tij të lartë. "Çelësi është në duart e tij dhe ai po punon shumë fort këto javë", tha Emery. "Ai duhet të stërvitet vazhdimisht dhe të luajë vazhdimisht pa u lënduar apo sëmurë. Kështu mund ta shohim Mesutin më të fortë me ne", shtoi ai.

Hazardit s'i intereson nëse Zidane vjen në Chelsea

Situata në Chelsea është mjaft e tensionuar për momentin dhe trajneri Maurizio Sarri është afër shkarkimit. Kjo situatë përkeqësohet edhe më shumë nga refuzimi i Eden Hazardit për ta pranuar ofertën për rinovimin e kontratës. Hazardi ka qenë vazhdimisht i lidhur me një transferim të mundshëm në Madrid, pasi që ai vet kishte deklaruar se ëndërron të luajë për klubin madrilen. Kur të hapet afati kalimtar i verës, belgu do ta ketë vetëm edhe një vit kontratë në Chelsea. Chelsea kishte shpresuar se mund ta bindë yllin belg të mos largohet nga klubi duke e emëruar Zinedine Zidane në pozitën e trajnerit, pasi që francezi ka qenë idhulli i Hazardit qysh kur ishte i vogël. Megjithatë, tani, e



përditshmja angleze, Daily Mail, raporton se as kjo taktikë e Chelsea nuk do ta bindë Hazardin të qëndrojë përtej këtij sezoni në Real Madridi, pasi që belgu tashmë ka vendosur ta realizojë ëndërrën e tij. Ai kishte bërë të ditur muajin e kaluar se e ka marrë vendimin përfundimtar për të ardhmen e tij dhe

përkundër që nuk kishte zbuluar se çfarë vendimi ishte ky, mediat angleze raportojnë se ai dëshiron të luajë në Santiago Bernabeu. Për më tepër, thuhet se ai e ka marrë dritën e gjelbër edhe nga drejtuesit e Real Madridit për t'u kërkuar drejtuesve të Chelseat të largohet nga Stamford Bridge.

Befason presidenti: Messi nuk është larguar asnjëherë nga Argjentina

Claudio Tapia tha për herë të parë zyrtarisht se Lionel Messi do të kthehet në kombëtaren e Argjentinës në ndeshjet e ardhshme. Ai shton se kjo është një gjë shumë e rëndësishme. "Messi është shumë i rëndësishëm për Argjentinën. Pa dyshim, kapiteni do të jetë në ndeshjet e radhës", - konfirmoi presidenti i AFA në një intervistë me "TyC Sports". Në këtë mënyrë, edhe pse lista e Lionel Scaloni do të publikohet më 4, ose 5 mars, kthimi i yllit të Barcelonës në listën e Albiceleste bëhet zyrtar. "Biseduam me të kur ishte "Superclásico" në Ma-



drid. Ai ka të njëjtën dëshirë për të luajtur me kombëtaren, si gjith-

monë. Messi kurrë nuk u largua, sepse herët e tjera ai nuk u thirr. Unë

mendoj se e kishte të nevojshme këtë lloj pushimi, për shkak të gjithçkaje që kishte përjetuar", shtoi presidenti i Federatës Argjentinase të Futbollit. Nga ana tjetër, Tapia theksoi se ky kthim i yllit të Barcelonës ndodh kur "konteksti i kombëtares sonë sot është shumë më i mbarë. Gjërat po përmirësohen. Argjentina jo vetëm që ka arritje sportive, por gjithashtu ka rifitur rëndësinë në të gjithë botën. Ne duhet të punojmë për të zhvilluar një "Copa America" shumë të mirë dhe të krijojmë bazat për Botërorin e Katarit".

LIGA E KAMPIONËVE

ALLEGRI: BESOJ TE KUALIFIKIMI



“Në ndeshjen e kthimit do të luajmë ndryshe. A besojmë te kualifikimi? Patjetër, më keq se kaq nuk mund të bëjmë. Loja fizike e Atleticos? Ata kështu luajnë dhe arbitri ka bërë një punë të mirë. Në Torino duhet të bëjmë një ndeshje të madhe për të siguruar çerekfinalet”, ka deklaruar Allegri

Massimiliano Allegri, trajneri i Juventus, është shprehur optimist për ndeshjen e kthimit të 1/8-ave të Champions League pas humbjes 2-0 të pësuar në “Wanda Metropolitan” kundër Atletico Madrid. “Në ndeshjen e kthimit do të luajmë ndryshe. A besojmë te kualifikimi? Patjetër, më keq se kaq nuk mund të bëjmë”, ka thënë trajneri i bardhezinjve për “Rai 1”. “Loja fizike e Atletico-s? Ata kështu luajnë dhe arbitri ka bërë një punë të mirë. Në Torino duhet të bëjmë një ndeshje të madhe për të siguruar çerekfinalet. Gjithsesi, tani duhet të mendojmë për kampionatin, sepse na presin tri ndeshje të vështira. Gjesti i Simeonos? Nuk e kam problem, këtu kështu është gjithmonë”, ka theksuar Allegri. Kapiteni i Juventusit, Giorgio Chiellini, e ka pranuar se Juventus është dashur të përqendrohej në ndërprerje, pasi pikërisht prej tyre pësoi dy gola, por insiston se mund ta përmbysin Atletico Madridin në ndeshjen e kthimit. “Ishin episodet ato që vendosën ndeshjen, e dinim se janë të rrezikshëm në goditjet standarde dhe duhet të ishim treguar më të kujdesshëm. Do të na duhet të tregohemi të qetë dhe të duruar në ndeshjen e kthimit nëse duam të kthejmë rezultatin, por do të luajmë për gjithçka në Torino. E menaxhuam mirë ndeshjen, në pjesën e dytë duhet të ishim treguar më të kujdesshëm pasi ato situata vendosin se kush shkon në çerekfinale. Gjithsesi, pas tre javësh do të jetë një ndeshje tjetër në Torino”, ka theksuar Chiellini. Die-

go Simeone tentoi ta shpjegojë festën e tij të turpshme në ndeshjen që Atletico Madridi e fitoi me Juventusin (2-0). Të dy gola erdhën nga mbrojtësit brenda katër minutave pas topave të hedhur në zonë. “Na u kthyen lojtarë të rëndësishëm si Koke dhe Costa. Ne ishim në gjendje të luanim një lojë inteligjente kundër një skuadre të madhe me lojtarë shumë të fortë. Është një rezultat shumë i mirë”, ka thënë Simeone. Çdo herë që Atletico ka fituar ndeshjen e parë 2-0, ata kanë kaluar në raundin tjetër. “Ne e dimë se po përballemi me një skuadër të madhe, një klub të madh dhe kampionë të mëdhenj. Ne presim plotësisht të vuajmë në ndeshjen e dytë. Unë e bëra atë si një lojtar në ndeshjen Lazio-Bologna dhe e bëra përsëri për të treguar tifozët tanë atë që kemi. Nuk e kishte qëllim ndaj ekipin tjetër, po u ktheva drejt tifozëve tanë. Nuk është një gjest i mirë, e pranoj, por e ndjeva nevojën për ta bërë këtë. Ishte një lojë e vështirë. Kemi luftuar kaq shumë dhe Diego Costa ka punuar shumë që të jetë 100 për qind i aftë. Më duhej

ta tregojta atë që ndjeja”, ka deklaruar Simeone.

KOKE: KURRË MOS E KONSIDERONI NJË EKIP ITALIAN TË VDEKUR, AQ MË TEPËR JUVENTUSIN

Koke tha se VAR do t’ia japë Alvaro Moratës një gol një ditë, pasi sulmuesi i Atletico Madridit shënoi me kokë, por pamjet televizive ia anuluan atë ndaj Juventusit. Morata mendoi se e bëri “sefte” tek Atletico Madrid, të mërkurën, në fitoren 2-0, por VAR hodhi poshtë gjithçka. 26-vjeçari, të cilit iu mohua një gol nga VAR edhe në humbjen e derbit të La Liga-s ndaj Real Madridit, më 9 shkurt, shënoi ndaj Szczesny dhe festoi me pasion, por rishikimi i rastit zbuloi se kishte shtyrë Giorgio Chiellini, duke bërë faull. Mesfushori i Atletico Madridit, Koke, iu tha gazetarëve: Më në fund, një ditë VAR do t’ia japë Moratës një gol. Ai ka shënuar dy gola, që i janë anuluar. Ne duhet t’i respektojmë vendimet, të shënojmë më shumë gola në rast se anulohen. Jemi shumë të lumtur për fitoren, por nuk ka mba-

ruar asgjë. Ne e njohim cilësinë e Juventusit, potencialin e tij. Bardhezinjtë kanë një nga ekipet më të mira në botë. Jemi të kënaqur me rezultatin, por asgjë nuk është vendosur ende. Kemi nevojë për një tjetër ndeshje të përsosur në kthim, që të kualifikohemi. Juventus është një nga më të mirët në botë. Kurrë nuk duhet ta paramendonin një ekip italian të vdekur, aq më tepër Juventusin. Do të përpiqemi të luajmë një ndeshje perfekte në Torino, ashtu siç bëjmë sot”, ka theksuar Koke.

GUARDIOLA: NUK JEMI AQ TË MIRË PËR TA FITUAR LIGËN E KAMPIONËVE

Menaxheri i Manchester Cityt, Pep Guardiola thotë se me formën aktuale nuk mund të fitohet Liga e Kampionëve. Citizens është dashur të djersiten shumë që me një lojtar më pak dhe në disavantazh prej një goli, të shënojnë fitore kundër Schalkes me rezultat 3-2 në Gjermani. “Tre gola dhe rezultati është një rezultat i pabesueshëm, por ende nuk jemi gati të luftojmë për Ligën e Kampionëve”, tha ai. “Unë


PARALAJMËRIMI I FRIKSHËM I MOURINHOS PËR JUVENTUSIN NË CHAMPIONS

Jose Mourinho ka ndërhyrë me parashikimin e tij për ballafaqimin e Ligës së Kampionëve mes Atletico Madrid dhe Juventusit. I intervistuar nga “Teleradiostereo”, trajneri portugez tha se bardhezinjtë mund ta synojnë Champions-in, por në të njëjtën kohë, nuk do të ishte surprizë për t’i parë bardhezinjtë të eliminuar nga “Colchoneros”. “Juventus mund ta fitojë Ligën e Kampionëve, - është i bindur trajneri luzitan. - Ka cilësi, përvojë dhe një lojtar vendimtar, si

Cristiano Ronaldo. Klubi ka një dëshirë të madhe për të fituar, sepse ka formuar një ekip me shumë ambicie. Sidoqoftë, edhe Atletico Madrid ka bërë një investim të madh, ka ambicie për të shkuar deri në finale, e cila do të luhet në stadiumin e tij. Simeone ka sulmues të mirë, që mund të bëjnë ndryshimin. Për këtë arsye, unë besoj se Juve mund ta fitojë Ligën e Kampionëve, por edhe mund të mos kalojë fare në çerekfinale”, ka theksuar Mourinho.

RONALDO NUK E HARRON DERBIN MADRILEN: UNË KAM 5 CHAMPIONS, PO JU?

Cristiano Ronaldo përjetoi një mbrëmje të zezë në Madrid, sepse Atletico e dërrmoi Juventusin dhe rezultati 2-0 është mjaft i vështirë për t’u përmbysur. Vetë portugezi nuk mundi të bënte shumë, mes mbrojtësve të hekurt të Atletico-s, ndërsa gjatë ndeshjes u nervozua jo vetëm për aktin se nuk po i ecte loja, por edhe për ngacmimet nga tifozët e Atletico-s, rivalët e egër të Realit, ku CR7 luante dhe fitonte trofe pa fund deri vjet. Batutat dhe ofendimet nga tribunat nuk kishin të ndalur, derisa Ronaldo u kthye nga tifozët dhe telekamerat e kapën duke bërë shenjën “5” me gishta. Pesë, si Champions që ai ka fituar me Realin, 5 si Topat e Artë që ai ka fituar. Pas ndeshjes Ronaldo nuk u ndal fare të fliste për gazetaret, ndërsa dukshëm nervoz tha në ecje e sipër: “Gjesti me dorë? Do të thotë që unë kam fituar 5 Champions, ndërsa ju zero. Do ta shohim kush do kualifikohet”.



jam më shumë se i kënaqur me rezultatin, por nuk është e mjaftueshme në këtë garë. Ne u dhamë atyre dy gola dhe kartonin e kuq. Në fazat e fundit nëse e bëjmë këtë, jemi jashtë garës. Ne jemi një ekip i mirë për t’u parë dhe shënojmë një sasi të jashtëzakonshme të golave. Personaliteti dhe mënyra se si luajmë është i mirë, por nuk mjafton. Ne u dhamë atyre mundësi. Ndoshta e kuptojmë rezultatin dhe mësojmë nga kjo, por çdo fazë është më e vështirë”, pohoi spanjollli. Kujtojmë se ndeshja kthyese mes këtyre dyja ekipeve do të zhvillohet më 12 mars (e martë) në stadiumin Etihad të Manchesterit. Ndryshe, City gjatë fundjavës do t’i kthehet ndeshjeve në Angli, përkatësisht do të luajë në finale të Kupës së Ligës dhe do të ballafaqohet me Chelsea.



DASHI 21. mars - 20. prill

Kjo do të jetë një ditë reflektimi për të lindurit e kësaj shenje. Ndoshta nuk i keni kaluar ende disa probleme të së kaluarës dhe kjo gjë nuk ju lë të qetë. Kjo vlen edhe për dashurinë. Duhet të rigjeni energjinë dhe qetësinë.



DEMI 21. prill - 21. maj

Keni një mijë projekte në kokë, të cilat duhet ti çoni përpara me pasion. Sa i takon punës, parashikohen disa ndryshime të cilat pritet të sjellin dobi. Do të ndjeni nevojën për t'iu përkushtuar familjes. Sa i takon dashurisë, mos u fiksoni pas personit të gabuar.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Kjo është një periudhë e mirë gjatë së cilës po shënoni rikuperime pas një sërë problemesh gjatë muajve të kaluar. Kjo e enjte nuk është idealja, pasi nuk do të jeni në humorin e duhur si për sa i takon punës edhe dashurisë. Ndoshta për shkak të disa kundërshtive në ambientin që ju rrethon.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Kjo ditë nuk do të jetë aspak pozitive, ku do të ketë disa momente tensioni. Do të donit të ndryshonit diçka në jetën tuaj por nuk ia arrini. Mundohuni që të organizoni diçka të kënaqshme për të rikuperuar disa raporte me persona të cilët i keni lënë pas dore.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Parashikohet një e enjte pozitive dhe e mbushur me energji, gjatë së cilës do të mendoni për të ardhmen. Duke qenë se yjet ju favorizojnë, mund të përfshihen lirisht në projekte të reja të cilët i keni menduar prej kohësh. Do të jeni të mbushur me entuziazëm.



VIRJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Kjo e enjte do ju gjejë të mbushur me energji. Shihni përreth pasi keni disa yje që ju mbështesin dhe favorizojnë takimet lidhur me punën por edhe ato sentimentale. Duhet të jeni gati për të tu përballur me disa risi, pasi do të jenë pozitive.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Gjatë kësaj dite bëni mirë të rrini të qetë, sidomos nëse dikush po mundohet që t'iu vendosë shkopinj nën rrota. Në fund do të rezultoni fitues edhe pse keni ende disa probleme për të rikuperuar.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Mundohuni që të kuptoni se kush janë personat më të rëndësishëm për ju dhe kush janë ata që duhet të largoni nga jeta juaj. Ka ardhur momenti për të bërë zgjedhje si në dashuri edhe në raportet miqësore. Mos u përkushtoni ndaj kujt nuk e meriton, pasi do humbni kohë kot.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

E enjtja nuk do të jetë një ditë aspak pozitive, ndaj lëreni që të ikë. Megjithatë kjo mbetet një periudhë e mirë sa i takon konfirmimeve në punë, ku do të përfjetoni momente suksesi.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Kjo ditë do të jetë vërtetë pozitive për të lindurit e kësaj shenje, të cilët do të ndihen gati që të përfshihen në projekte të reja. Yjet ju favorizojnë, veç bëni kujdes ndaj ndonjë problemi të papritur që mund t'iu dalë përpara.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Parashikohet një ditë mjaft pozitive për ndjenjat, ndërsa në punë nuk do të jetoni momentet më të mira. Mundohuni që të gjeni një mënyrë për tu relaksuar dhe për të mposhtur lodhjen dhe stresin e akumuluar.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Mbani mbi supë disa brenga të së kaluarës. Në nivelin emocional dhe sentimental jeni përballur me disa ndryshime, ndoshta edhe konflikte. Ndoshtë jeni një person që kërkoni kohë për të rikuperuar, ka ardhur momenti që të shihni përpara.



22 SHKURT 1732
14 DHJETOR 1799

KOHA	POSTI MË I LARTË I POLITIKANIT NË FOTO	RREGULLAT E GOJETARISË	GUR I CMUAR, IN GJASHËM ME KUARCIN	GARDA USHTARAKE	POSEDON	Mensur Mamuti	KOMANDATI DHE THEMELUESI I SHBA-VE, NË FOTO	AGJENTI AMERIKAN, NES	NOFKA E POLITIKANIT NË FOTO NXJERR FOSHNIJËN NË JETË	B
GOZHDE TË SHKURTRA, QË U VIHEN KËPUÇEVE					ËMBËLSIRË (BEKTASHINJSH) VEND I NGRITUR PRANË LUMIT	"MIXHA" HUMORIST NGA SHKUPI				
ANËTAR I NJË PARTIE AMERIKANE						UJHESË NË DALMACI				
SHKRONJË GREKE				NJË NGA KRYETARËT E SHBA-VE, REGAN MUNDËSI TURK, HALIT		KËNGËTARJA KOSOVARE, BILURDAGU				
POLITIKANIA NORVEGJEZE, ERNA						AKTORJA AMERIKANE, FOSTER				
IRIDIUMI			AUTORJA ANGLEZE, KRISTI MORALI			UNIVERSITETI I TETOVËS			ITALIA VARGMALE NË RUSI	
TRUPI I ZJARRTË QIELLOR, BURIM DRITE MBRET HELEN I KRETËS					SHIKOJ DIÇKA PËR NJË KOHË TË GJATË, KUNDROJ PËLHURË MERI-MANGE, CERGE	LOJË TRADICIONALE, GOMARTHI, KALORAZI				
K						SHENJË QË PËRFAQËSON NJË TINGULL MUZIKOR NIKELI				
POETI RUS, ANATOLI								KËNGËTARI AMERIKAN, KING KOLL RADIUMI		
TEMPERATURA		BIMË JUGOAMERIKANE, KOKRRAT E SË CILËS ZIHEN FOSFORI							ULTRA-VJOLLCE "TRIMI" I BJESHKËVE TË NEMURA	
KOHA										KËNGË E TUNËS, "..."

ZGJIDHET: B, XHELA, OLIV, RINA, XHODI, UT, I, KA, UV, PROG, ASHURE, REPUBLIKAN, ETA, RONALD, SOLBERG, II, IR, AGATA, T, DIELL, SODIT, KEKTAM, NOTE, NAIMAN, NAT, T, KIKIRIKI, I, PARE, ASAJ.

Shumë i lehtë **Sudoku** mesatar

						6	5					2	1						
3		6	9									6	2			7		5	
2	9			5									1		9			2	
		8		3		5		7				6	9		3			1	
		2	3			5	6						4				7		
1			7		8							1				8		5	3
					7			8	1						2		3	7	
					9	7		6						8				6	
5		8										4	6	7		3			

Shumë i lehtë: 847213695, 356984217, 291657843, 984365172, 723491568, 165728934, 639572481, 412839756, 578146329. Mesatar: 459281637, 862437915, 731596842, 695374281, 384152796, 127968453, 518629374, 273845169, 946713528.

DËSHIRONI TË HUMBNI PESHË? MJAFTON TË NDIZNI TELEVIZORIN

Në rast të mungesës së disponimit, si dhe dëshpërimin për të humbur peshë, juve do iu mjaftonte të ndeznit televizorin. Të paktën, kështu po pohon një hulumtim, i realizuar nga Universiteti i Westminster.

Sipas tyre, shikimi i filmave horror ndihmon në djegien e kalorive dhe, rrjedhimisht, edhe humbjen e peshës. Shkencëtarët, të udhëhequr nga Richard McKenzie, sponsorizuan një testim në disa persona vullnetarë, të cilët i ekspozoheshin një filmi një orë e gjysmë. Ata që shikuan film nga ky zhanër, ishin në gjendje të digjnin 113 kalori, e cila përkthehet në shetitje prej 30 minutave ose vrapim prej 15 minutash. Këta tre fil-



ma shkaktajnë djegien më të madhe të kalorive në mesin e të anketuarve: "Shining" - 184 kalori "Jaws" - 161 kalori "Exorcist" - 158 kalori.



Samsung ka lansuar Galaxy Fold dhe Galaxy S10.

Firma shpalosi pajisjen fleksibile, e cila varion nga një smartfon 4.6 inç në një mini tabletë prej 7.3 inç, gjatë Eventit të Paketuar në Auditoriumin Bill Graham të San Franciskos sot. Samsung gjithashtu prezantoi Galaxy S10 dhe S10+, që thotë se krenohet me 'ekranin më të saktë të ngjyrave ndonjëherë në një pajisje të lëvizshme'. Samsung gjithashtu zbuloi partneritetin e ri me Instagram për të sjellë një veçori të veçantë të kamerave të mediave sociale në linjën e saj S10: Instagram Mode. Nënkrjetari i Produktit të Marketingut të Samsung, Justin Denison lansoi produktet e fundit në mëngjesin e të mërkurës, duke filluar me Galaxy Fold. Samsung thotë se Galaxy Fold do të dalë në treg më 26 prill, i cili do të etiketohet me çmimin 1.980 dollarë. Specifika të tjera do bëhen të ditura më vonë.

Depresioni dhe ankthi, problemi më i madh për adoleshentët

Shumica e adoleshentëve thonë se depresioni dhe ankthi janë problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohen gjenerata e tyre. Në një studim të "Pew Research Ceneter" del se 70% e grupmoshës 13-17 vjeç në SHBA e shohin shëndetin mendor si një "problem të madh", ndërsa 96% e kanë cilësuar si "problem të vogël". Bulizimi është një tjetër shqetësim për adoleshentët që me 90% e listojnë si problemi të dytë më madhor për ta. Sipas këtij studimi të "Pew Research Ceneter", droga dhe alkooli janë shqetësime që radhiten në vendin e tretë dhe të katërt. Adoleshentët e kanë cilësuar si shqetësim edhe varfërinë si dhe shtatzëninë në adoleshencë.



SA HERË DUHET TË LAHEN REÇIPETAT? JA Ç'THONË EKSPERTËT



Ruajtja e higjienës personale dhe e cilësisë së veshjeve takohen në pyetjen: "Sa shpesh duhet t'i lajmë...?" Është e ditur që bluzat duhet të lahen pasi mbahen gjithë ditën veshur, por mund të vishën sërish nëse mbahen vetëm për pak orë. Sipas fjalëve të Tyra Banks, modelja dhe prezantuesja e America's Next Top Model, xhinset mund t'i vishni edhe për 7-8 javë rrjesht deri në larjen e ardhshme.

Për mbathjet mund t'i ndërroni sa herë në ditë të dëshironi, mjafton mos të kaloni 12 orëshin. Por përgjigja për reçipetat ka qenë gjithnjë e vështirë. A duhet të lahen po aq shpesh sa mbathjet? Do të prisheshin shpejt dhe kushtojnë shumë. Nuk duhet të lahen asnjëherë? Epo, çdo gjë ka nevojë të pastrohet, sidomos diçka që vishet. Pra, sa është përgjigja e duhur? Ekspertët propozojnë se për të ruajtur

cilësinë por edhe të jenë të pastra, mund t'i vishni deri në 6 herë para larjes së ardhshme. Sigurisht, kur reçipetat mbahen në veshura gjithë kohës bëhet fjalë, jo nëse mbahen për pak orë. Në muajt e verës apo kur lëkura është e yndyrshme, duhet të lahen më shpesh. Këshillohet që intimit të lahen me dorë që të mos u prishet forma, por edhe ngjyra apo cilësia.

1349 - Dëbohen hebrenjtë nga Cyrihu i Zvicrës.

1744 - Beteja e Tulonit: Flotat Anglezo-fraceze kundër asaj spanjolle.

1746 - Trupat franceze okupojnë Brukselin.

1821 - Spanja shet Floridën SHBA për 5 milion dollarë.

1825 - Rusia dhe Britania vendosin kufirin mes Kanadasë dhe Alaskës.

1828 - Rusia dhe Persia nënshkruajnë Traktatin e Turkmencait për paqe.

1847 - Beteja e Buena Vistas: Trupat amerikan mundin ushtrinë meksikane.

1888 - John Reid nga Skocia u demonstroi sportin e golfit amerikanëve.

1900 - Havai bëhet territor i SHBA.

1939 - Holanda njihet regjimin e Frankos në Spanjë.

1945 - Formohet Liga Arabe në Kajro.

1958 - Egjipti dhe Siria formojnë Republikën e Bashkuar Arabe.

30 MINUTA USHTRIME NË MËNGJES STABILIZOJNË TENSIONIN E GJAKUT



Tridhjetë minuta ushtrime në mëngjes kanë efektin e njëjtë me ilaçet për uljen e presionit të gjakut dhe mbajtjen e tij të reduktuar për pjesën tjetër të ditës. Shkencëtarët në Australi zbuluan se një stërvitje e shkurtër - në këtë rast, një ecje me intensitet të moderuar - potencialisht mund të zëvendësonte nevojën për ilaçe në disa pacientë. Fondacioni britanik Heart mirëpriti hulumtimin, i cili është premtues në veçanti në lidhje me presionin e gjakut sistolik: tensioni në enët e gjakut kur ka rrahje të zemrës.

NUK JE SHTATZËNË?

- Po më the edhe një herë e shëndoshë midis nesh mbaron gjithçka!
- Po pse moj zemër, mendo pak për fëmijën tonë...
- Për çfarë fëmije po flet more???
- Po pse zemër, nuk je shtatzënë?



Jam aq i mençur sa që nganjëherë nuk e kuptoj një fjalë të vetme në atë se çfarë jam duke thënë.

(Oscar Wilde)